

'Jo secili prej nesh mund të bëjnë gjëra të mëdha, por të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe' Nënë Tereza



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 130, gusht 2014  
 Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## SIKUR TË ÇMITIZOHESHIN GJËRAT!

editorial nga LAZER KODRA

2



Kulturat e ndryshme botërore kanë lindur dhe janë identifikuar, si të tilla, mbi bazën e miteve, gojëdhënavë e më pastaj të legjendave, proverbeve e të gjitha esencave folklorike që e përbëjnë atë si të tillë. Çdo kohë ia ka lënë vendin një kohe tjetër dhe ligjet e natyrës kanë thirre brenda saj një brez tjetër. Ne, që jetojmë kohët e sotme, nuk mund të ripërsërisim kohët e së kaluarës ashtu sikurse të shkuarit në të ashtuquajturën "Botë e përtëjshme" nuk mund të rikthehen në skenën e kohës që jetojmë ne. Kështu i bie që secili brez të përcjellë vetveten, brenda barkut të pafundmë të kohës, me vlerat që arrin të krijojë përgjatë qendrës në unitet të materies me idetë. Nëse një brez nuk pranon realitete të reja, do të thotë që ai nuk ka lëvizur, ruan shabllonin e së shkuarës si pjesë të lavdisë, mençurisë, krenarisë e te të gjitha gjërave të tjera. Tendanca e ndasive, në të gjithë botën, po shkon drejt eliminimit. Sa do të kishte lëvizur shoqëria njerëzore sot sikur mitet greke, egjiptiane, romake, indiane, kineze e shumë të tjera do të pranoheshin si dominuese te skenave kulturele. Po sikur dramat të luheshin në mënyrë korale si në kohët e lashta, apo bejtet të zinin vendin e parë në krijimtarinë letrare? Po sikur subjektet e tragjedyve të Eskilit, Sofokliut, Shekspirit e shumë të tjerëve të gjenin bazë reale në botën e sotme, sa hapa përpara do të kishte bërë shoqëria njerëzore?...

## DUKAGJINI - rrugëtim në gjenezë

NJË LIBËR PËR BREZAT E ARDHSHËM - Bashkëbisedim me autorin Luigj Shyti



3

Fillimisht është kënaqësia ime që të bëjë këtë intervistë për shtypin e ditës me juve i nderuari Luigj Shyti.

Ju jeni lindur dhe rritur në Thethin e mrekullive natyrore. Çfarë kujtimesh na sjell për lexuesit nga ky fshat me zë dhe i njohur brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë?

Thethi është pa asnjë mëdyshje nga dashuritë e mija më të mëdha. Aty u linda, aty u rrita, aty mora mësimet e para shkollor deri në mbarim të shkollës 7 vjeçare, sepse ashtu ishte në atë kohë. Aty mora njohuritë e para për jetën. Thethi ka qenë dhe është një nga fshatrat më të bukura të Shqipërisë në të gjitha drejtimet. Ai ka vlera shoqërore, historike, kulturore dhe turistike të vendit tonë me vlera të papërsëritshme. Thethi është i banuar qysh rreth 3000 vjet më parë. Popullimi i këtij fshati ka rreth 300 vjet nga paraardhës të banorëve të sotëm. Thethi ka edhe malin e lartë ku dëborat nuk shkrin asnjëherë, ka edhe ujin e lumit të ftohtë dhe të kristaltë, në të cilin rritet...

## Rimodelimi i projektit të ndarjes administrative

Pak ditë më parë një projekt i ndarjes së re administrative iu paraqit nga shtypi, publikut shqiptar, i cili po pret tani nga qeveria një shpjegim të bazuar, mbi një ekspertizë shkencërisht ndërdisiplinore, mbi këtë subjekt me rëndësi vitale për procesin modernizues të vendit dhe ndërtimit të një qeverisjeje sa më përfaqësuese dhe të evropianizuar. Kjo reformë administrative po kryhet në kushtet e heshtjes së plotë dhe të mungesës së një reforme kushtetuese, një reforme të sistemit zgjedhor, gjë që e vendos sistemin në një situatë të papërshtatshme. Kështu janë tre reforma që nuk mund të ndahen lehtësisht nga njëra tjetra në një vend normal të perëndimor.

5

## TRE MINISTRA ME ORIGJINE SHQIPTARE, NE QEVERINE E GIUSEPPE GARIBALDIT

6



### Fakt historik

Familja fisnike Gjuraj, renditet në 22 familjet fisnore shqiptare në kohen e mesjetës, sipas Gjin Varfit, botuar në librin "Heraldika Shqiptare" dhe ka stemën e vet, e cila është e prere në të arte dhe në të kaltër, me një dhi të argjendte, të ngritur në dy këmbët e pasme (grafia në librin "Heraldika Shqiptare" fq. 58)



Mundësoi Botimin:  
GJERGJ LEQEJZA



Ma.di.sh Kimay  
PRODUCTION Produzione Glacche

# SIKUR TË ÇMITIZOHESHIN GJËRAT!

editorial nga LAZER KODRA



Kulturat e ndryshme botërore kanë lindur dhe janë identifikuar, si të tilla, mbi bazën e miteve, gojëdhënave e më pastaj të legjendave, provëbave e të gjitha esencave folklorike që e përbëjnë atë si të tillë. Çdo kohë ia ka lënë vendin një kohe tjetër dhe ligjet e natyrës kanë thirre brenda saj një brez tjetër. Ne, që jetojmë kohët e sotme, nuk mund të ripërsërisim kohët e së kaluarës ashtu sikurse të shkuarit në të ashtuqajturën "Botë e përtëjshme" nuk mund të rikthehen në skenën e kohës që jetojmë ne. Kështu i bie që secili brez të përcjellë vetveten, brenda barkut të pafundmë të kohës, me vlerat që arrin të krijojë përgjatë qëndresës në unitet të materies me idetë. Nëse një brez nuk pranon realitete të reja, do të thotë që ai nuk ka lëvizur, ruan shabllonin e së shkuarës si pjesë të lavdisë, mençurisë, krenarisë e te të gjitha gjërave të tjera. Tendencat e ndasive, në të gjithë botën, po shkon drejt eliminimit. Sa do të kishte lëvizur shoqëria njerëzore sot sikur mitet greke, egjiptiane, romake, indiane, kineze e shumë të tjera do të pranoheshin si dominuese të skenave kulturore. Po sikur dramat të luheshin në mënyrë korale si në kohët e lashta, apo bejtet të zinin vendin e parë në krijimtarinë letrare? Po sikur subjektet e tragjedyve të Eskilit, Sofokliut, Shekspirin e shumë të tjerëve të gjenin bazë reale në botën e sotme, sa hapa përpara do të kishte bërë shoqëria njerëzore? Po sikur Evropa të ishte e copëzuar si para një shekulli dhe SHBA të ishin të pabashkuara si do të vente halli? Unë jam i sigurt se asnjë pjesë, sado e vogël qoftë, as e Evropës as e SHBA nuk e humbi identitetin për arsye se u bënë pjesë integrale e një

bashkësie më të madhe. Në këtë kuadër, mendoj unë, se aty ku ka shumë njerëz, ku ka shumë lëvizje, ku ka shumësi kulturash, edhe pjesa kulturore e një grupimi njerëzish që i bashkojnë shumë gjëra, bëhet shumë ma e dukshme. Këtë mund ta krahasoj me një tufë lulësh në të cilat janë tufëzuar të gjitha ngjyrat. Nëse pretendohet se përfaqësuesit tanë janë vlera nacionale, atëherë na humbet e drejta që t'i mbajmë ato të rrokura në gjinj si vlera fisnore, krahinore apo edhe më gjerë. Me këtë metodë, unë mendoj se i turrim ato krejt padrejtësisht. Nuk besoj se një fis apo krahinë në Greqi të himnizojë e pronësojë Eskilin, në Itali Danten, Petrarken, Bokaçon, Mikelanxhelon, Da Vinçin, në Angli Shekspirin, në Francë Balzakun, në Rusi Tolstoin, në Spanjë Servantesin, në Gjermani Gëten e qindra figura të tjera botërore. Nuk do të kishte respekt më të keq për Ta, se sa t'i mbanin si pronë të një province. Historia e gjithësisht tregon, se sot idetë provinciale nuk janë bashkëkohore. Ajo që dua të kujtoj është fakti, se asnjë nga këto figura që përmenda më lart nuk e ngjiten vetveten duke e mbështetur "shkallën" në shpinën e tjetrit. Kjo gjë ka shërbyer si bazë e uniteteve tërësore, qoftë edhe kulturore, që deshëm e nuk deshëm ne, po lulëzojnë në pjesët më të kulturuar të botës. Nuk besoj aspak, se një francez mund t'i "krekoset" një anglezi duke i thënë: "Balzaku ka qenë më i mirë se Shekspiri", apo raste të ngjashme nga vende të tjera me kulturë të zhvilluar. Tek ne, shqiptarët, kanë ndodhë fenomene të çuditshme! Vlerat tona i përdorim për kundërvënien brenda llojit, deri në shkatërrimin përfundimtar të tyre. Nuk do të kisha ndonjë lavdi të madhe as për ata idhujt tanë, që në një formë apo në një tjetër ngjallen një lloj urrejtje pandemike ndaj gjithë fqinjëve që kemi rreth e rrotull. Ky lloj "mësimi", për mua është shumë i keq, na ka ngulitur në mendje sentencën: "Unë jam ma i miri!" Në studimet e tij, shumë i njohuri Shaban Sinani, thotë se një ndër bazat e bashkimit të Evropës në një e të

vetme ka qenë edhe zhdukja e miteve, të cilat popujt i kishin ndërtoar mbi shpinën e njëritjetrit. Tek ne, kjo gjë nuk po ndodhë. Dy figura dukagjinase, Martin Camaj dhe Lin Delia, për mendimin tim kishin fate imbugue. Fati i keq: Regjimi i egër i detyroi Ata për të braktisur atdheun e tyre; fati i mirë: Jetuan në vendet e lirive dhe shfaqen vlerat e tyre me peshë evropiane. A meritojnë Ata që sot të bëjmë përpjekje për t'ua ngushtuar përmasat e kornizës duke thënë: Këta janë vetëm dukagjinase, ndërkohë që Evropa i ka glorifikuar si vlera në të gjithë hapësirat kulturore e gjeografike të saj. Larg qoftë, sikur të kishin jetuar në këtë vend se kush do të kishin mbetur Ata! Vlerat e së shkuarës vetëm bukë nuk mund të bëhen, as meny e fjalorit të përditshëm, as justifikim i përhershëm në seleksionin që sjell progres. Ato vlera janë pasuri e vyer e një krahine, populli, nacionaliteti dhe mund të përdoren si të tilla qoftë në një simpozium shkencor, qoftë nëpërmes një ekspozite fotografike, qoftë nëpërmes një koncerti folklorik e shumë formave të tjera, por kurrsesi nuk mund të përthithin gjithë kohën tonë në të cilin jetojmë. Kështu i bie që ose të jemi thjeshtë shabllone të të shkuarës ose plagjiaturë pa vizione të reja. Thuaje, ka tre dekada që nuk kam parë dasmë në Dukagjin, ku nusja dhe dhëndri të ishin veshur me kostume tradicionale të krahinës, ndërsa dukagjinasi e zbritur në Shkodër, për fatin shumë të mirë, e kanë aplikuar këtë gjë shpeshherë në dasmat e tyre që kanë bërë në mes të Shkodrës. Kjo do të thotë, se këta njerëz i njohin vlerat e tyre, interesohen për to, i shfaqin në raste të tilla dhe pastaj i kthehen rrjedhës normale bashkëkohore. Për mendimin tim, kjo është ruajtja reale e vlerave. Mund të ofendohet një dukagjinasi, për faktin se sot mban kollare dhe të parët e tij mbanin gozhup prej leshi, një dukagjinasi që sot nuk mban mustaqe dhe të parët e tij i mbanin ato, një dukagjinasi që sot këndon muzikë rrok, ndërsa të parët e tij këndonin kënga majëkrahut? Unë mendoj se jo, madje përkundrazi tregon, se një kulturë ia ka lëshuar ven-

dit një kulture bashkëkohore. Kjo nuk do të thotë, aspak, se ky person i ka harruar traditat, zakonet, të parët e tij e te tjera, e te tjera, në të kundër, arsyeja të çon se ky lloj personi mban në kujtesë dhe respekton të kaluarën ashtu siç di të zotërojë kohën e vet. Të gjitha këto, për mendimin tim, e kanë bërë tek bashkëjetesa në komunitet të gjerë, aty ku shumë mendësi produktojnë më të mirën, aty ku edhe zhurmat përkthehen në muzikë. E gjithë kjo lloj rezymeje, që bëra më lart, e ka pikënisjen tek "humbja" e emrit Dukagjin si njësi me vete administrative territoriale, me ndarjen e re administrative. Ata që e kundërshtuan janë shokët e mi më të mirë. Diversiteti i mendimeve nuk na bën keq. Mendoj, se ai problem fitoi në një moment trajta populiste, bëri karshillek ndaj njësi të tjera simotra, tregoj një ego disi jo shumë të motivuar, u ngjall ideja e pakrahësueshmërisë me askënd tjetër, pati një lloj kontradiksioni me thënien tonë të përhershme: "Ne jemi shkodoranë, pse na paragjykon si dukagjinasi!?", dhe ç'është ma e rëndësishmja, ne nuk kishim një njësi vendore me emrin Dukagjin. Jemi ne, që qindra herë rreth tavolinave e në mbledhje të ndryshme kemi deklaruar: "Komunitat e Dukagjinit janë fantazma!". Të gjithë ne e dimë, se ku janë sot qendrat e komunave të Dukagjinit, që për t'i qëndruar korrekt të vërtetës, ato janë përqendruar në lokale të Shkodrës, duke pas kusht ngjyrën politike të lokalit. Gjithnjë do t'i kujtoj porosinë e kohë mëparshme të Gjergj Perlucës, Ahmet Osjes, Fadil Krajës që thoshin: "Bëni pasaportizimet në Shkodër, përndryshe do të keni shumë problem në të ardhmen!". A është tronditës një fakt i para dy viteve: -Një nënë shkon me të birin për ta regjistruar në klasë të parë, pranë një shkolle në Shkodër, kur paraqet certifikatën e fëmijës mësuësja i thotë: "Nuk mund ta regjistroj, pasi banoni në X komunë!" - Nëna e fëmijës i paguan nën dorë 2 000 leke, ndërkohë që asistencën mujore e kishte vetëm 2 200 leke. Besoj se është një fakt domethënës, për problemin në fjalë. Po pse pyesim ne të afërmit tanë që i kemi emigrant: A i keni letrat ne Itali, Gjermani,

Greqi e të tjera? A e ke blerë shtëpinë me letra apo pa letra? -Po token ... me letra apo pa letra? Kjo do të thotë se, kur je pa letra, je i barabartë me mosqenien. Ne, të gjithë, duhet të bëjmë kujdes që një punë që e bëjmë sot të mos na zhgënjë nesër. Asgjë më tepër nuk na ka stresuar se sa punët që i kemi bërë vetë dhe të nesërmen nuk kemi pasur mundësinë që t'i fshijmë, pasi na kanë krijuar zhgënjim e nuk duam t'i kujtojmë më. Askush më herët se sa Arbëreshet e Italisë nuk u larguan nga ky vend, por askush më mirë nuk i ruan identitetet. Po ne pse kemi frikë nga një gjë e tillë? Jemi brenda vetvetes, brenda tokës sonë, brenda llojit tonë e gjërat mund t'i bëjmë shumë më mirë nga ç'janë.

## SA PËR MBYLLJE

Burri i urtë nga Shala, i ndjeri Vatë Martini, thoshte: "Lufta përkundra (kur shikohet nga larg) dhe dasma ndër shokë janë të bukura, por kur të bien në derë janë të vështira!". E citova këtë thënie si një përgjigje dashamirëse për disa zëra të largët, të cilët më duket se shpeshherë e humbasin arsyen dhe priren drejt instinktit. Thirrjet e tyre u ngjasojnë borive me brirë kau për të rrokur shpatat në një luftë donkishoteske brenda llojit, brenda atij lloji që ka Histori të përbashkët, Heronj të përbashkët, Folklor të përbashkët, Gjuhë të përbashkët, një lloj kuzhine të përbashkët dhe të gjitha këto që përmenda formësojnë atë që quhet Nacionalitet. Këto thirrje vijnë pikërisht nga ata persona që askush nuk ua mohoi këtë Atdhe me emrin Shqipëri, por u larguan për një jetë më të mirë, të cilën ua urojmë. Nëse emigrantët e pas viteve 90' sollën në këtë vend shume vlera materiale dhe monetare, janë shumë deficitarë për sa u përket ideve të reja dhe vlerave evropiane! Nga ata presim të përcjellin kulturë, maturi, paqe e jo valë të nxehta, se sa për koka të nxehta kemi vetë mjaft. Në fund të fundit një vatan i lëshuar është vatan i humbur. Këtë e pranonte edhe Mikel Maruli, i cili nga Italia shprehej asokohe: "Ne jemi fajtor, sepse ikëm nga vatani dhe ua lamë të tjerëve, duhej të rezistoshim aty!"

# DUKAGJINI - rrugëtim në gjenezë

**NJË LIBËR PËR BREZAT E ARDHSHEM - Bashkëbisedim me autorin Luigj Shyti**

Fillimisht është kënaqësia ime që të bëjë këtë intervistë për shtypin e ditës me juve i nderuari Luigj Shyti.

**Ju jeni lindur dhe rritur në Thethin e mrekullive natyrore. Çfarë kujtimesh na sjell për lexuesit nga ky fshat me zë dhe i njohur brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë?**

Thethi është pa asnjë mëdyshje nga dashuritë e mija më të mëdha. Aty u lindi, aty u rrita, aty mora mësimet e para shkollor deri në mbarim të shkollës 7 vjeçare, sepse ashtu ishte në atë kohë. Aty mora njohuritë e para për jetën. Thethi ka qenë dhe është një nga fshatrat më të bukura të Shqipërisë në të gjitha drejtimet. Ai ka vlera shoqërore, historike, kulturore dhe turistike të vendit tonë me vlera të papërsëritshme. Thethi është i banuar qysh rreth 3000 vjet më parë. Popullimi i këtij fshati ka rreth 300 vjet nga paraardhës të banorëve të sotëm. Thethi ka edhe malin e lartë ku dëborat nuk shkrin asnjëherë, ka edhe ujin e lumit të ftohtë dhe të kristaltë, në të cilin rritet trofta e shijshme dhe shumë e sertë. Në Theth dhe rrotull tij rriten rreth 200 lloje bimësh të egra, mjekësore, të ngrënshme dhe ngjyruese. Ka bimë endemike, midis të cilave Vulfenia e Baldaçit në Brinjën e Shtegut të Dhenve në lartësinë rreth 1800 m mbi det. Në Theth ka ujëvara dhe kanyonë shumë të bukura. Turizmi ka filluar mjaft herët, por vitet e fundit ka marrë një zhvillim të vullshëm. Pas një turravrap për tu larguar dhe për të gjetur vend për një jetë më të mira, qoftë brenda vendit apo jashtë tij, vitet e fundit kanë filluar ndërtimet dhe zgjerimet e banesave nga banorët vendas. Pra duket se banorët thet-hjan po i kthehen vendlindjes së tyre.

**Ju jeni një ndër studentët e viteve të kahershme të Dukagjinit, si arritët të arsimoheshit dhe si ishin ato vite?**

Pasi mbarova shkollën 7 vjeçare në Theth në një mjedis shumë të këndshëm, kërkova që të vazhdoj shkollën e mesme, mundësisht për mjekësi ose mësuesi. Të dyja këto degë i kisha me shumë qejf, por më shumë mjekësinë. Vazhdimi i shkollës për mjekësi nuk u bë i mundur, sepse më sa duket nuk e lejonte një njollë në biografi. Më doli e drejta për të vazhduar shkollën e mesme të përgjithshme tre vjeçare në Durrës me të drejtë për ta vazhduar Institutin Pedagogjik të Shkodrës drejt për drejt. Kjo bëhej me qëllim që të përgatiteshin mësues sa më shpejt për të përballuar zgjerimin e arsimit që paskësh qenë në plan që të bëhej në të ardhmen. Atje, pak nga vështirësitë ekonomike të largësisë, pak se nuk e kuptuam, veçanërisht prindërit, këtë lloj shkolle dhe dukej shumë gjatë për të dalë në punë për të ndihmuar familjen, nuk u bë e mundur që të shkollohesha në atë kohë. Sapo mbarova shkollën 7 vjeçare i u futa punës në kooperativën bujqësore, direkt në bujqësi. Punoja sa kisha mundësi, por isha shumë i disiplinuar dhe krijoja marrëdhënie shumë të mira me të gjithë pjesëtarët e tjerë, me të cilët më takonte të punonim bashkë.

Edhe sot kujtoj me shumë respekt shumë ish kooperativistë të moshuar në atë kohë, që, më merrnin pranë pa asnjë përtesë dhe punonim bashkë, megjithëse ata punonin më shumë se unë, ditën e punës e kishim të barabartë. Mbaja marrëdhënie shumë të mira me mësuesit që kryesisht ishin nga qyteti apo zonat fushore, pavarësisht se kisha mbaruar shkollën, por merresha me drejtimin e rinisë në fshat dhe kjo më ndihmonte edhe për lidhjet me shkollën dhe mësuesit. Nga fundi i viteve '60 u shtrua detyra nga shteti që të shtrihej arsimit

e preferuar. Nuk kisha besim se do më botohej, por kur e pashë të botuar të them të drejtën u kënaqa dhe disi mora zemër për të shkruar përsëri. Më vonë kam shkruar shpesh herë sidomos në gazetën lokale të Shkodrës, por edhe "Zëri i Rinisë", "Ylli", "Bashkimi", e më vonë edhe në gazetën "Mësuesi".

**Me që jemi tek shkrimet desha të bëj një pyetje të drejtpërdrejtë, kur keni botuar librin e pare, çfarë kujtoni, si u ndjeve përpara publikut?**

Ah, librin tim të parë e kam botuar,

mjaftë të mira. Pas mbarimit të shkollës së mesme kërkova që të vazhdoj shkollën e lartë, por për dy vjet më pengon një karakteristike që duhej të lëshonte ish sekretari i organizatës së Partisë, më vonë kolegu dhe vartësi im. Kam mbaruar Shkollën e lartë në Shkodër për biologji-kimi, dhe këtu me rezultate mjaft të mira. Me mbarimin e shkollës nuk mbaronte kualifikimi, por do të vazhdohej me kërkesa shumë të forta, që përjashtonte problemet ideologjike të kohës, të tjerat ishin të domosdoshme.

Punën mësimore e mora me shumë pa-



i detyruar 8 vjeçar në të gjithë vendin. Në këtë kohë arsimit i detyruar kishte kaluar nga 7 vjeçar në 8 vjeçar. Unë nuk dija asgjë për këtë, por një ditë një mësues i shkollës nga qyteti më thotë se do të merrren nxënës që kanë të gjitha notat 10-ta për të punuar si mësues, pasi kuadri i deri atëherëshëm nuk i përballonte. Pas disa kohe dhe peripecish, që shkon gjatë po ti kujtojmë të gjitha, emërohem mësues në fshatin Plan të Pultit.

**Keni qenë një i ri që e donit dijen dhe kulturën, lexonit, por dhe shkruanit në organe të ndryshme shtypi, nëpërmes të cilave të kam njohur në distancë. Shkruanit reportazhe të ndryshme, shkrime problemore, informacione e te tjera. Si ju lindi dëshira dhe si e kujtoni botimin tuaj të parë?**

Dëshira për të shkruar në shtypin e kohës ishte që herët, sapo mbarova shkollën 7 vjeçare dhe fillova punën me rininë e fshatit. Kisha dëshirë që të publikoja fshatin tim dhe punën e rinisë. Shkrimi i parë që më është botuar, dhe ky ishte i pari për shtypin, ka qenë për Thethin, ku jepej një informacion mbi gjendjen social kulturore të këtij fshati. Ja kisha dërguar me postë të zakonshme revistës "Ylli", që botohej një herë në muaj. Ishte revistë

vonë, në vitin 2005. Ky botim ishte një përmbledhje publicistike të shkruara në kohë të ndryshme për Dukagjinin. Ai e ka titullin "Dukagjini ka vend për të gjithë". Ishte një nxitje nga disa shokë e miq të mijë, por edhe dashamirës të Dukagjinit, që më nxitën. Dua ta përmendë se mbështetjen financiare për botimin më bëri një ish nxënës im nga Thethi, Angjelin Vidhi. Libri u pritë mirë, mendoj unë, dhe ka qenë i kërkuar jo vetëm nga bashkëkrahinarët e mijë, por edhe nga shumë të tjerë. Jam ndjerë mirë me të.

**Si ka qenë jeta si mësues dhe ku e filluat karrierën si mësues dhe ku e mbyllët këtë karrierë shumëvjeçare?**

Dita e parë e shkollës ishte me katër klasa kolektive, me sistem gjashtë orësh dhe pa parë asnjë orë mësimi si kandidat për mësues. Shumë e vështirë dhe që kërkonte punë shumë të madhe për tu përballuar. Emërimi mësues kishte edhe një detyrim, që të vazhdonim shkollën dhe ta merrnim brenda katër viteve, ose duhej të lenim punën. Kjo më pëlqente, sepse kisha shumë dëshirë që të vazhdoja, sidomos pas një lodhje rreth katër vjeçare në punë të ndryshme në kooperativë. Shkollën e mesme pedagogjike në Shkodër e mbarova për tre vjet dhe me rezultate

sion. Punova me përkushtim që nxënësit, të cilët unë mësoja apo shkolla që unë drejtoja të merrte njohuritë më të mira të mundshme, dhe të them të drejtën kur bëheshin krahasimet midis lëndëve dhe shkollave gjithmonë isha mbi mesataren.

Gjatë punës time në frontin e edukimit, për rreth 32 vjet kam punuar drejtues shkolle. Kam pasur në qendër të vëmendjes gjatë punës në shkollë, krijimin e një mjedisi të këndshëm në të cilin punonim, jo vetëm si godinë dhe kushte materiale por edhe shoqërore, me qëllim që nxënësit dhe mësuesit të vinin me qejf në shkollë. Marrëdhëniet midis kolegësh, edhe kur isha mësues i thjeshtë, por aqma më shumë kur drejtoja në shkollë ishin përparësia ime në atë mënyrë që të zbatoheshin ligjet, udhëzimet dhe urdhrat që vinin me ndjenjën e dashamirësisë, pa ngritje zëri, duke qenë vetë në krye të punëve. Në të gjitha shkollat që kam punuar kam krijuar marrëdhënie shumë të mira edhe me komunitetin dhe këshillat e fshatrave.

Puna ime në arsim është interesante, ose të paktën kështu me duket mua. Kam punuar në të gjitha klasat që nga e para dhe deri në klasën e dymbëdhjetë, kam punuar me klasa kolektive

në të gjithë sistemin shkollor para universitar, kam punuar me klasa kolektive me sistem 4 orësh dhe me sistem 6 orësh, kam drejtuar shkolla 8 vjeçare, dhe të mesme të bashkuar në të cilin përfshiheshin edhe shkolla 8 vjeçare me të gjitha klasat dhe shkolla e mesme, madje edhe me klasa paralele. Po të ishte në ushtri nga ushtarak i tillë do të quhej "ushtarak karriere".

Punën mësimore e kam mbyllur me 31 gusht 2012, pas pothuaj 45 vjet punë. Kur po afrohej koha për tu ndarë nga arsimit, bisedoja me kolegët e mijë dhe më kujtohet një shprehje që më erdhi krejt pa prituri, që u thashë: "... më vjen edhe keq, por edhe mirë që po largohem". Ata filluan ta komentonin sipas dëshirës gjithsecili. Unë u shpjegova atyre, se më vjen keq sepse kam një jetë në këtë profesion dhe nuk është e lehtë ndarja, nga ana tjetër më vjen mirë që po largohem pa asnjë masë ndëshkimore sado e vogël, përkundrazi i dekoruar dy herë, po largohem pa parë gjatë gjithë punës time në arsim një aksident te nxënësit e shkollës ku punoja, pa bërë fjalë për ngjarje më të rënda, pa parë asnjë ngatërrës midis mësuesve të shkollës që drejtoja. Kjo më lehtëson shpirtin dhe ndjehem mirë që u largova kështu.

Punën në arsim e mbylla në shkollën 9 vjeçare "Tonç Gjon Toma" në Rragam të Gurit të Zi, një shkollë model me plotë kuptimin e fjalës si nga paraqitja, disiplina e punës, niveli i përvetësimit të mësimit krahasuar kjo jo vetëm me shkollat e fshatit, por edhe te qytetit, dhe mbi të gjithë me një kolektiv shembullor në të gjitha drejtimet. Përulem me shumë respekt, edhe sot, përpara tyre.

#### **Si je ndjerë atë ditë kur ti u ndave përfundimisht nga profesioni?**

Asnjë ndarje nuk është e lehtë. Atë ditë ndarja më shkaktoj një ndjenjë shpirtërore mjaftë emocionale sa që edhe u "turpërova" sepse mu mbushën sytë me lot. Në atë ndarje përfundimtare, në ata lot, ndikuan edhe vendet e tjera të punës ku kam punuar më parë që nga Plani në Dukagjin që kam filluar dhe pastaj në disa shkolla të Dukagjinit si mësues e drejtues, në Velipojë, Karmë, Gurë të Zi dhe së fundmi në Rragam. Në mënyrë të përmbledhur shumë shkurt, ato emocione, ishte një përvijim i një rruge 45 vjeçare në shkollë.

Me që ra fjala te dita e fundit e punës në shkollë, po kujtoj këtu një mungesë respekti nga Drejtorja e Arsimit të Qarkut, e cila nuk erdhi dhe as nuk dërgoi një njeri, në shenjë respekti që po largohej një drejtor shkollë. Por duhet thënë se fajin e ka edhe politika që ka hyrë thellë në gjakun e disave, të cilët nuk dalin dot nga ajo baltë. Megjithatë unë ja kam bërë të qartë asaj, me shkrim, këtë mungesë respekti për atë që kam më shumë punë në arsim se ka vite ajo. Siç e thash pak më parë, lashë një shkollë model, me të gjitha klasat e fillores dhoma të vërteta puna për të gjitha lëndët, ciklin e lartë me gjashtë kabinete nga më të mirët, sipas lëndëve, pa asnjë xham të thyer, me të gjitha kushtet shumë të mira për punë dhe edukim.

Kam një respekt të veçantë për të gjithë komunitetin e fshatit Rragam, për marrëdhëniet personale dhe kolektive me ta, për kujdesin e tyre për mirëmbajtjen e shkollës dhe dashamirësinë për shkollën.

**Ju jeni një qytetar i nderuar, një**

#### **prind shembullor, një aktivist i pa lodhur, po kush është familja e juaj?**

Unë kam bashkëshorten dhe pesë fëmijë, tashmë të rritur relativisht. Katër i kemi të martuar dhe tre prej tyre janë me fëmijë, ndërsa djali i vogël është i fejuar. Janë të shpërndarë në tri vende të ndryshme të botës. Unë ndjej shumë kënaqësi për familjen time. Ajo ka qene mbështetëse e pa zëvendësueshme në jetën dhe punën time. Na mungojnë shumë fëmijët dhe nipat e mbesat që janë larg, por vinë nganjëherë dhe çmallemi me ta. Djali i vogël ka mbaruar një fakultet dhe një doktoraturë për bioteknologji të avancuar, dhe tash vazhdon studimet për mjekësi humane.

#### **Tani të rikthehem tek qëllimi i intervistës. Juve jeni botues i disa librave, sa është numri i botimeve tuaja, çfarë trajton në vetvete ç' do libër i shkruar nga ju?**

Këto ditë doli në qarkullim një libër që bën fjalë për gjenezën e Dukagjinit. Ky është i pesti që kam shkruar. Kam qenë bashkëpunëtor apo organizator edhe në libra të tjerë.

Katër nga librat e mijë kanë në qendër Dukagjinin. Në këto libra flitet për historinë, kulturën, natyrën, vlerat shoqërore dhe shkencorë që unë kam pasur mundësi që ti shikoj, ti dëgjoj dhe ti përshkruaj. Dukagjini është një krahinë me shumë vlera në të gjitha drejtimet. Për këtë krahinë kanë shkruar edhe shumë e shumë, udhëtarë, gazetarë, studiues, shkencëtarë, që nuk kanë të sosur. Sa herë shkon në Dukagjin, qoftë vendas apo i huaj gjënë gjëra të reja. Është një zonë me shumë vlera, që ka përbulluar shumë vështirësi natyrore dhe shoqërore, prej të cila ka nxjerrë shumë mësim. Në këto libra kam trajtuar edhe probleme të kohës, siç është përshtatja me të rejat e kohës, problemet e integritit në kohën dhe shoqërinë e re, kam shkruar shumë portrete, kam dhënë shumë informacione që ju vlejnë edhe rrugëtarëve, studiuesve e dashamirësve të Dukagjinit. Në këto libra kam mbledhur një numër këngësh lirike-erotike që janë kënduar dhe këndohen edhe sot në Dukagjin, që tregojnë se malësori dukagjinas nuk u lind për të vrrarë apo për tu vrrarë, siç përpiqen ta paraqesin ndokush, por e do jetën, e do lirinë, e do dashurinë, e do familjen, e do përparimin, e do të bukurën.

Një nga librat e mijë është një vëllim me poezi, ashtu siç i kam ndjerë unë, të shkruar në kohë të ndryshme, por një pjesë e tyre i kushtohet emigracionit, kësaj plage që mbetet e hapur, që ka prekur shumë e shumë familje dukagjinase dhe shqiptare.

#### **Si janë pritur botimet tuaja dhe a kenë pasur ndonjë mundësi për botimin e tyre e, në se ke pasur, kush janë?**

Librat e mijë jam i kënaqur për pritjen që i ka bërë publiku. Mendoj se secili që ka marrë në dorë nga këto libra ka gjetur edhe veten e tyre brenda. Kjo mendoj se është mjaft e rëndësishme.

Në botimin e tyre, natyrisht, më kanë ndihmuar të afërmit si dhëndëri Alfred Kola dhe vajza Rrezearta, im vëlla Gjovalini, djali i motrës Kreshnik Vocaj, bashkëkrahinari dhe kolegu e miku im Kolë Çardaku, ish nxënësi im Angjelin Vidhi, që e përmenda edhe pak më parë. Të gjithëve u jam mirënjohës me shumë

respekt.

#### **A mund të na flasësh pak për botimin tënd të fundit, që nga titulli, kopertina dhe brendia e tij. Kujt i dedikohet?**

Libri im që sapo doli në qarkullim titullohet "DUKAGJINI – rrugëtim në gjenezë", botuar nga shtëpia botuese "FIORENTIA" në Shkodër. Është një libër me 540 faqe, dhe teknikisht i punuar me shumë kujdes. Kopertina është e bërë në funksion të temës që trajtohet në faqet e librit. Tregon përpjekjet për të ndriçuar prejardhjen e një krahine mjaft të vjetër në kohë, por edhe mjaftë të gjerë në hapësirë. Ky libër është i vetmi, deri tash, për këtë temë për këtë krahinë, por uroj që të mos jetë i fundit. Libri trajton, në mënyrë time, gjenezën që shumë herët dhe në një territor shumë të gjerë. Është i konceptuar nga larg afër. Për rreshtimin e brezave është filluar nga brezi më i ri dhe kam ecur drejt thellësisë. Për këtë libër janë lexuar dhe konsultuar 116 libra, prej të cilëve 42 me autor të huaj si dhe shumë revista, gazeta, dhe shumë materiale të tjera arkivore. Nga këto studime janë grumbulluar mbi 2 000 skeda. Janë vjelë mendimet e mbi 180 personave të moshave dhe profesioneve të ndryshme në Shqipëri, por edhe në trojet shqiptare jashtë kufijve shtetëror. Këtë libër e kanë njomur me mendimet e tyre edhe shume persona që e kanë lexuar në dorëshkrim, por veçanërisht konsulentët e mijë Profesor As. Dr. Zef Gjeta, Profesor As. Dr. Ahmet Osja, Ndue Sanaj, Ndoc Grimaj, Alfred Haxhari, Lulash Gilaj, Zef Bari, të cilët më ndihmuan me mendimet e tyre të vlefshme, dhe që i përsërites me respekt. Ky libër ka një parathënie të zgjeruar nga Prof. Zef Gjeta, dhe një mbyllje nga Alfred Haxhari, të cilat edhe analizojnë punimin, por edhe hellin vështrimin drejt së ardhmes.

Ky libër i kushtohet brezit të ri dhe atyre që do të vinë. Është domosdoshmëri e jona që të bëhemi, më sa të mundemi, dëshmitarë të kohës që jetojmë dhe atyre që dimë, për brezat e ardhshëm.

Çfarë tregon fotoja jote në kopertinën e fundit?

Kjo foto, për mua, ka një një veçori interesante. Këtu jam në ditën e fundit të punës në shkollë. Ma bëri një koleg, mësues i shkollës Rragam me aparatim tim, sepse doja që të bëja disa foto të shkollës dhe kolektivit. Kjo foto me sjellë kujtime nga koha e punës.

#### **Ju jeni sekretar i Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", redaktor i gazetës "Dukagjini", si arrini ta përballoni këtë ngarkesë, dhe si është bashkëpunimi me kolegët tuaj krijues?**

Po jam i zgjedhur që në themelimin e shoqatës. Shoqata "Atdhetare Dukagjini" ka bërë dhe vazhdon të bëjnë punë shumë të mirë për zbulimin, ruajtjen dhe publikimin e vlerave të mira të kësaj krahinë me shumë vlera. Për shoqatën tonë, Dukagjini dhe vlerat e tij të mira, janë në plan të para, për kryesinë e kësaj shoqata dhe për gjithë shoqatën, Dukagjini është "partia" mbi të gjitha partitë që janë në Shqipëri. Ne kërkojmë që të shtohet vëmendja për këtë krahinë dhe këta malësorë, dhe mbështesim cilin do që punon me mirë dhe më shumë për zhvillimin dhe përparimin e kësaj krahinë, për integrimin e këtyre malësorëve kudo që jetojnë.

Ne kemi punuar, me sa mundësi që kemi, për të ndikuar edhe të emigrantët tonë në ruajtjen e traditave të mira krahas atyre bashkëkohore të cilat janë të pashmangshme dhe të domosdoshme.

Unë përpiqem që të jap ndihmesën time në shërbim të brezit të ri dhe atyre që vinë, sepse u jemi borxhëlinjë se, dikur do të na gjykojnë. Për këto duhet gjetur kohë nga i gjithë brezi i sotëm dhe veçanërisht intelektualët, sepse pa tjetër që e ardhmja mbështetet në të sotmen. E kam shënuar edhe në botimin tim që doli këto ditë se, ata që dinë kush janë dhe nga vinë, dinë ku shkojnë dhe çfarë kërkojnë.

Me kolegët e mijë krijues dhe të shoqatës kemi bashkëpunim të vazhdueshëm dhe pa interesa personale e politike partiake. Kjo ka bërë të mundur që të kemi një shoqatë shumë solide dhe që ka mbështetje të mirë në komunitet. Kjo marrëdhënie shoqërore ka ndihmuar që të bëhen aq shumë botime me temë nga Dukagjini. Këto shtojnë besimin se do të vazhdohet puna e suksesshme edhe në të ardhmen.

**Unë kam pasur nderin që të kem të ftuar në emisionet e mija në dy radio në emigracion. Publiku ju ka vlerësuar mjaftë mirë, si një njeri me njohuri bashkëkohore në shumë drejtime të jetës, ju siguroj që jam ndjerë edhe unë krenar që, Luigj Shyti, një djalë Dukagjinas, prej nga vi edhe unë, të jenë vlerësuar nga dëgjuesit e shumtë. Besoj që edhe kjo intervistë me juve do kenë lexueshmëri, do vlerësohet puna e juaj shumë vjeçare. Çfarë do tu thash lexuesve në përfundim të kësaj interviste? Çfarë planesh dhe objektivash keni për të ardhmen?**

Do të punoj me sa mundësi që kam në shërbim të familjes time, të krahinës prej nga rrjedhë, të vendit në tërësi. Kam projekte për botimin e ndonjë libri me studime apo publicistikë. Interesante, besoj se do të jenë studimi mbi bimët mjekësore të Thethit, dinamika e popullsisë pas viteve '90 në krahinën e Dukagjinit, pse jo edhe ndonjë me kujtime, apo tjetër tematikë. Gjithsesi këto në vartësi të kohës në dispozicion që do të kemi.

Në mbyllje të këtij bashkëbisedimi dua të ju falënderoj posaçërisht Ju, zoti Gjini, që edhe në distancë gjete kohën dhe mundësinë për të bashkëbiseduar bashkë. Është shumë e shpejtë kërkesa juaj për të bashkëbiseduar, vetëm disa orë pas daljes së librit të fundit në qarkullim. Kam plot dy vjet që jam në pension dhe je i pari që më "ngacmon", më ktheve, disi, në kohën e rinisë dhe punës, gjë të cilën mund ta kishin bërë ata që i kam më afër, nga kolegë apo ish kolegë, bashkëpunëtorët apo ish bashkëpunëtorët. Unë mendoj se nuk është kohë e humbur kur pasqyron edhe pak treshita punën afër 50 vjeçare të një kolegu apo bashkëpunëtorit. Për këtë të falënderoj ngrohtësisht i dashur Gjini.

Ju falënderoj edhe një herë për kohën që vure në dispozicion të realizimit të këtij bashkëbisedimi.

Urime për librin e ri!  
Ju faleminderit!

*Bashkëbisedoi  
Gjin Musa  
Romë*

# Rimodelimi i projektit të ndarjes administrative



Prof. dr. Romeo Guakuqi

Pak ditë më parë një projekt i ndarjes së re administrative iu paraqit nga shtypi, publikut shqiptar, i cili po pret tani nga qeveria një shpjegim të bazuar, mbi një ekspertizë shkencërisht ndërdisiplinore, mbi këtë subjekt me rëndësi vitale për procesin modernizues të vendit dhe ndërtimit të një qeverisjeje sa më përfaqësuese dhe të evropianizuar. Kjo reformë administrative po kryhet në kushtet e heshtjes së plotë dhe të mungesës së një reformë kushtetuese, një reforme të sistemit zgjedhor, gjë që e vendos sistemin në një situatë të papërshtatshme, mbasi janë tre reforma që nuk mund të ndahen lehtësisht nga njëra tjetra në një vend normal të perëndimuar. E them këtë sepse nuk mund të bësh reformë administrative, duke lenë në harresë, themelin e Shtetit, Kushtetutën, që përcakton formën e organizmit shtetëror dhe sistemin e qeverisjes dhe mbi të gjitha duke harruar nevojën e përditshme që ka vendi për rregullimin e sistemit konstitucional, rregullimin e parlamentarizmit që është aktualisht në rrethana të pangjashme me sisteme parlamentare në Evropë. Ndërkohë nuk mund të iniciosh një reformë administrative pa qartësuar në fillësë metodologjinë dhe kriteret e përdorura për realizmin e saj, si edhe duke e heshtur kërkesën se ajo reformë administrative do i paraprijë ndryshimit të parimeve të kodit zgjedhor dhe sistemit zgjedhor në tërësi.

Nga harta e projektit më të fundit, duket qartësisht se ndërtesat e projektit kanë qenë jashtë ekspertizës ndërtimore, pa një metodologji shkencore të barazvlefshme në territor, të pabazuar në konsiderata etnologjike, historike dhe të pa pajisur me patentën e nevojshme të ekspertizës administrative, instrumente këto që përgatitnin situatën për një korrigjim të nesërm të sistemit elektoral, në rrethanat kur sistemi aktual ka sjellë produktin parlamentar më të shëmtuar të historisë pluraliste të këtij vendi të prapambetur dhe më progres të mundshëm.

Është një ndarje administrative e krijuar pa një emërtim paraprak të komuniteteve me identitete historike korresponduese. Kra-hina të tilla si Malësia e Madhe, Dukagjini, Nikaj-Mërturi, Malësia e Gjakovës, Mirdita dhe të tjera në Jug të vendit, që i kanë dhënë jo pak Shqipërisë me historinë e tyre qendrestare, si dalazotese të këtij dheu, meritojnë të njihen si krahina me ndarje me vete, të rindërtohen në gjendjen e vet reale dhe të kenë përfaqësuesit e tyre në Parlament dhe jo të mbesin në situatën e caktuar nga regjimi komunist si në 1946

Ndarja e propozuar nuk ka arritur dot të përkufizojë territore gjegjëse, as të emërtojë bashkësi, as të përcaktojë dot seli të dobishme për institucione që do të instalohen për njësitë, si edhe nuk ka arritur të bëjë një hyrje përmbledhëse historike të ndarjeve administrative të Shqipërisë, 1913-1945, kohë kur logjika dhe arsytimi ishin në fuqi. Është një ndarje që propozohet nga lart, që përfiton nga gjendja e bashkësive krahinore dhe kultura imponuese e ndër-tueme nga diktatura dhe post-diktatura, mbi periferitë e vendit dhe nga procesi i shprishjes së komuniteteve të krijuar nga emigracioni dhe imigracioni, për të kërkuar bindje pa oponencë.

Nevoja prioritare për thjeshtëzimin administrativ të vendit, kushtëzuar nga kërkesa e rritjes së efektivitetit qeverisës, shkurtimit të shpenzimeve, në thelb më ngjan se është deformuar nga interesa parciais politike, të partive të paketës kontrolluese të Shtetit më 2014, individëve me oreks të pandalshëm brenda tyre, që luftojnë për përjetësi në sistemin politik shqiptar, dhe interesave sunduese të një piramide politike që nuk e dëshiron, madje frikohet nga një rikthim i ndarjes administrative në strukturën fillestare të Shqipërisë tradicionale. Nevojat modernizuese administrative janë përdorur për të fshirë kujtimin e një Shqipërie me shtet unitar, por me ndarje administrative që respektonte komunitetet tradicionale të Shqipërisë natyrale, duke imituar taktikat e diktatorit, që fshinë blloqet e kundërshtisë ndaj regjimit të instaluem përdhunshëm. Për rrjedhojë edhe sot është prodhuar përgjithësisht një ndarje administrative, produkt i kompromiseve (rasti i kompromisit të paparimit me PDIU është tipik), që mundësojnë përfundimin e domeneve të politikës, ngurtësojnë sistemin aktual politik piramidial dhe pro-

porcional të përfaqësimit, siguron edhe më tutje dobësimin e nukleve kompakte të popullsisë dhe posaçërisht deformojnë prirjet politike tradicionale liberale dhe jo komuniste brenda konstruktive sociale të shoqërisë shqiptare etj. Nuk është një hartë e krijuar pa studim të interesave. Përkundrazi, është një ndarje e menduar krejt mirë nga pikëpamja e parimeve që u mundësojnë kastave të kristalizueme politike, mbijetesën në një sistem jo krejtësisht të lirë, jo demokratik dhe të kontrollueshëm në pikëpamje të ndërtimit politik, bazuar në besnikërinë klanore dhe të tarafit piramidial. Është një hartë fuzionare, e ngjashme me ata harta administrative që diktatori i krijoi për të mbytur forcën e disa krahinave përjetësisht të lira në frymë, mendje dhe atdhetari në Shqipëri, për të pasur në vijim, një dominim mbi ata. Është një skemë që mbytet identitetet qytetare të kristalizueme në shekuj, duke i përzierë në një vorbull interesash që janë, ose të ndryshme, ose të pamjaftueshme për nga pikëpamja e nivelit edukativ dhe kulturor, për t'u njësuar në një përfaqësim të përbashkët. Me duket si një përpjekje shoshitëse dhe barazimtariste që shmang shtratin e përfaqësimi identitar i qyteteve, me përputhshmëri kulturore dhe asfikson demokracinë që prodhon e rrezaton një polis i vërtetë. Me të njëjtin kujdes eliminues që u fshinë nga ndërtesa e Parlamentit aktual, fotografitë e MARUBI-t, dhe nga administrata e Parlamentit, qytetarët shqiptarë të shkolluar në perëndim, komisioni parlamentar i dirigjuar në prapaskenë nga inxhinierët e politikës, ka ngatërruar skemat ndarëse të Shkodrës dhe Korçës qytetare, të Mirditës, të Dukagjinit, të Malësisë së Madhe, të Himarës, të Vurgut dhe të Konispolit etj.

Nga ana e saj, opozita politike, edhe këtë radhe, në kaosin e saj vetmitar e destruktiv, gjendet e papërgatitur për të ndërtuar edhe një faqe parimesh ndërtimore, e jo më një hartë alternative, me qartësi metodologjike, perspektivë politike, administrative, dhe me kujdesin e nevojshëm për përfaqësim identitar reale të fillësës. Dhe s'ka si të jetë ndryshe: ajo në vijimësi nuk e ka pas të qartë përmbytjen e Atdheut të vet Real, kompozimin e tij, interesat regjionale dhe promovimin e kanaleve të lirisë në shtet, nevojën përfaqësimeve adekuate, por ka flirtuar me kundërshtarët e vet politikë për krijimin e zonave të sigurta elek-

torale, për luanët e luaneshat e politikës, që u kanë mundësuar këtyre dominuesve të mëdhenj, mbijetesën në sistemin transitiv politik shqiptar.

Projekti i një ndarjeje të re administrative, në rrethanat e një qeverisjeje që pretendon të jetë sa më e përgjegjshme dhe sa më përfaqësuese, do të duhej të kujdesej: 1. për thjeshtëzimin administrativ dhe rritjen e operativitetit ekzekutiv të qeverisjes të vendit; 2. për korrigjimin e dëmtimeve që iu bënë nga diktatura komuniste, ndarjeve tradicionale të Shqipërisë; 2 të kishte kujdesin maksimal për përfaqësimin e përshtatshëm dhe të përputhshëm të krahinave etnografike shqiptare, të cilat, në fund të fundit, janë shprehëse edhe të një vullneti politik dhe kulturor identitar, të cilin do të duhet ta marrë në konsideratë çdo qeveri; 4. të kishte kujdesin më të plotë për ruajtjen e qendrave më të rëndësishme urbane të vendit që kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm centrifugal në forcimin e prirjeve zhvillimore demokratike, arsimore, kulturore dhe ndërtimin e përfaqësimeve sa më të rëndësishme intelektuale shqiptare; 5. është nevoja e përfaqësimit politik në organin e sovranit: shkrija sërisht e disa zonave tampon të krijuara nga diktatori, dhe e pjesëzave krahinore shumë të rëndësishme, të integruara artificialisht në krahina pa ndërlidhje antropologjike e kulturore. Ndarja administrative e bërë në periudhën 1946-1990, nuk përbën më argument për ruajtjen e mëtutjeshme të kësaj harte të dekompozuar nga Liria në Shtet dhe nga standardet evropiane të njohjes së identiteteve krahinore; 6. lidhur me nevojën e përfaqësimit politik, do të duhet të theksojmë se vendi ndodhet para urgjencës së ndryshimit të kodit zgjedhor dhe sistemit zgjedhor, drejt një sistemi mazhoritar një emëror me prag të lartë, ose drejt një sistemi të përzierë proporcional-mazhoritar, sikurse është ai gjerman. Këtë ndryshim e ka bërë të domosdoshëm dhe imperativ situata e krijuar në Parlamentin aktual, i dekompozuar në fillësë nga niveli i përfaqësimit që prodhoi ligji aktual në fuqi, situata e degraduar e partive politike piramidale, familjare dhe jo demokratike në Shqipërisë, destabiliteti permanent politik dhe sfida e ndryshimit radikal të sistemit politik aktual që e ka prodhuar këtë realitet të dhimbshëm.

Shteti Shqiptar do të duhet

të jetë i organizuar në Komuna të inkluduara në Bashki, Qytete Metropolitane, Provinca dhe Rajone dhe për këtë është i nevojshëm një ndryshim kushtetuar më shumë.

Provincat mund të kenë një kryebashki si kryeqendër, që përfshin brenda saj një krahinë të tërë, përfshi edhe komuna, por në provinca nuk mund të përfshihen qytete të tilla të mëdha si Tirana, Shkodra, Durrësi, Korça, Vlora, Elbasani. Është më e arsyeshme dhe më e dobishme në aspektin e përfundimit të polisit në Shqipëri dhe e kulturës që një qytet tradicional promovon në areal, krijimi i njësisë administrative të Qytetit Metropolitan, si një tip i veçantë i Provincës, ndërtuar brenda zonës verdhë të qytetit, i karakterizuar nga një raport i ngushtë integrimi. Nuk mund të shkrihet administrativisht një qytet historik shqiptar, në një bashkësi aq të përzierë interesash rurale, siç ndodh me ndarjen e re administrative që po projektohet. Korça, Shkodra, Vlora, Durrësi, Elbasani, Berati e Gjirokastra, nuk mund të shkrihen administrativisht, por do të duhet të përfundohen në rrethin e linjës së verdhe dhe të shërbejnë edhe me tutje si qendra centrifugale të qytetërimit dhe të urbanizimit shqiptar. Projekti e injoron plotësisht këtë ekzistencë.

Projekti fillestar i reformës përmbante krijimin e Rajonit si njësi më e madhe administrative që e shoh të zhdukur në projektin e paraqitur në shtyp. Kjo nuk duhet të ndodhë për një seri arsyes, por para së gjithash për shkak të nevojave zhvillimore dhe përfshirjes së Shqipërisë në proceset zhvillimore sipas regjioneve. Është më pas e diskutueshme nëse rajonet, do të duhet të gëzojnë autonomi Statutare, Financiare dhe Rregulluese.

Problemi tjetër shumë i rëndësishëm nga i cili vuan situata e përfaqësimit në Shqipëri është ndarja dhe nëndarja e distrikteve elektorale, shumë e pavaforshme për përfaqësimin e minoriteteve kulturore. Në qoftë se minoritetet kulturore do të bashkoheshin në distrikte të veçanta sikurse natyrisht kanë qenë, në krahina elektorale të veçanta, ose në një sistem proporcional përfaqësimit, ata do të duhet të jenë në gjendje me zgjedh përfaqësinë e vet, ndërsa nën këtë sistem të ofruar, ata do të jenë nën mëshirën shumicës, së imponuar nga mekanizmi i pamëshirshëm i partive politike.

(vijon në faqe 7)

# TRE MINISTRA ME ORIGJINE SHQIPTARE, NE QEVERINE E GIUSEPPE GARIBALDI

1 - **FRANCESCO CRISPI**, u lind me 4 tetor 1819 ne Ribera, afër Palazzo Adriano, ku prindërit kishin një prone bujqësore. (kujtojmë se shtëpia e tij ekziston



ende, fale ristrutturimit te përhershëm nga shteti). Crispi (Krispi) vjen nga një familje arbëreshe, i cili pas mbarimit te disa shkollave, ne vitin 1846 fillon aktivitetin si avokat ne Napoli. Me 12 janar 1848 shpërthen revolucioni sicilian ne Palermo, ku Krispi merr pjese direkt, por pas një disfate te këtij revolucioni largohet për ne Piemonte, ku bën pune te ndryshme si gazetar, pastaj ne Malte, Paris e Londër. Prej andej bën thirrje për bashkimin e Italisë ne krah te Garibaldi. Marshimi garibaldian merr rrugë me 5 maj 1860 ku bie edhe Palermo dhe Krispi emërohet Ministër i Brendshëm dhe i Financave. Me vone zgjidhet deputet. Me 1873 gjendet ne krye te se majtës italiane, me 1876 zgjidhet President i Dhomës se deputeteve dhe ma vone zgjidhet President i Këshillit Ministrave ne periudhat 7 gusht 1887 - 6 shkurt 1891, pastaj 15 dhjetor 1893 - 14 qershor 1896, është Sekretar Shteti dhe Ministër i Jashtëm. Vdes me 12 gusht 1901 e varrosset ne Palermo. Populli dhe shteti italian e kane nderuar dhe vazhdojnë ta nderojnë këtë figure te madhe. Me rastin e 150 vjetorit te bashimit te Italisë, Crispi i inaugurohet një varr madhështorë ne vendlindje (27 dhjetor 2011). Personalitet ma te ndershëm asht zor te gjendet. Fjala e fundit ne prag te vdekjes ishte: "Para se te mbyll sytë përgjithmonë desha te dije diçka për atdheun tone, athu po nderohet e mbrohet nga te gjithë bijtë e tij!"

2- **PASCUALE SCURA (SKURA)**, u lind me 24 prill 1791 ne fshatin arbëresh Vaccarizzo Albanese (Cosenza). I ati, Agostino ishte një pronar i vogël toke, ndërsa e ëma, Rosa Ferraiolo ishte nga fshati Santa Sofia d'Epiro, qe i takonte një familje anti borbone, për te cilën me vone pati edhe pasoja. Pascuale studion ne kolegjin Italo-Shqiptar te San Demetrio Corone, ku njihet me kulturën greke e latine. Mëson fizike, anatomi e filozofinë nen drejtimin e doktor Pietro Scura. Me 1814 laurohet ne mjekësi dhe me 1817 emërohet këshilltar pranë Gjykatës Kriminale ne Kalabri dhe me vone si gjykatës ne "Gran Corte Criminale" ne Katanzaro, ne Bari, ne Leçe,

ne Kozenza e te tjera dhe me 1840 arin gradën e Prokurorit te Përgjithshëm. Shpesh i miri dhe i zoti vihet ne shënjestër. Edhe Pascuale Scura nuk i shpëton këtij



ndëshkimi. I detë e tij liberale i bien ndesh Fernandit II. Arbëreshi ynë i mire arin deri ne bankën e te akuzuarit, duke i shtuar edhe akuzën për përmbysje shteti. Për ti shpëtuar një hakmarrje te mundshme e dënimit, Pascuale gjene strehim ne rrethinat e Napolit e me vone me një anije nen flamurin francez se bashku me te birin, Angelino shkojnë ne Gjenova. Pasi gjenovezet nuk i dhanë shtetësinë, ai thotë fjalën e madhe qe mbeti ne histori "Unë jam italian e jo Piemontez", qe do te thoshte se jam për Italinë e bashkuar. Arrin ne Torino, kryeqyteti piemontez, ku pritet nga bashke patriotet arbëresh. Ne kafene te tyre "La Perla", ne mes shokëve e bashkëvendësve mbanë një fjalim, qe me vone asht përmbledhë te libri "Emigranti" te shkrimtarit Francesco Perri. Me 18 mars 1857 kthehet ne vendlindje, te gruaja Maria Concetta Mele, por sa zbrit ne Napoli i jepet dënim me arrest shtëpie. Në Vaccarizzo Albanese shkojnë arbëreshet nga te gjitha anët ne përkrahje te tij, por fatkeqësisht nuk arin te takohet me te gjithë, pasi u përfshi ne lëvizjen Garibaldiane. Mbreti Fernando II bie nga funksioni i ndjekur nga «Mille Garibaldiani» dhe me 4 korrik 1860 Pascuale Scuro emërohet Prokuror i Përgjithshëm ne Kampobase. Me 27 shtator 1860 emërohet Ministër i Drejtësisë. Ne këtë detyrë, duke mbështetë plebishitin popullor për Italinë e Bashkuar. Detyra e fundit e Skurës ishte te ne detyrën Këshilltar i Gjyqit Suprem te Kazacionit ne Napoli. Me 12 janar, gjate festimit te Vitit Gjyqësorit ne Napoli, goditet nga një sëmundje e papritur dhe pas pak i lëshon shpirtin ne dorën e Zotit.

\*\*\*

Miku im i mire dhe kryetar i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj është i mendimit se, një vend me emrin GJURA (Gjuraj) ndodhet në Dukagjin, në krahinën e Pultit. Gjithashtu dimë se, në Kopolik të Sipërm ndodhet një lagje, me emrin Gjuraj, dhe sipas gojëdhënës, i pari i tyre erdhi nga fshati Gjuraj të Pultit, prandaj lagja ka marre këtë emër. Nëse Gjurajt,

që po theksoj me poshtë kane lidhje me këtë rrënjë, do të shohim më vone. Por, gjithsesi po jap dy të dhëna: **Së pari**, në librin "Heraldika Shqiptare" me autor Gjin Varfin, në faqen 58, shkruan: "Familja fisnike Jura (Gjura), është dege me familjen princërore Cernojeviqi, e njohur që me 1322. Jurajt ishin aleate të Balshes III. Qendra administrative e Gjurajve ishte vendbanimi Gjuraj, Malësi e Shkodrës. Pas pushtimi osman, një dege e Jurajve (Gjurajve) emigruan në Shebenik (Dalmaci)". **Së dyti**, në librin "Shqiptaret e Italisë", me autor Kole Kamsi, në faqen 236 dhe 239, shkruan: "... Me 1478 (në katundin Bratile, të provincës Potenca) u-venduen të parat familje shqiptart. ... Ndër fise t'ardhuna prej Shkodre asht në za familja Giura (Gjura) ... Në katundin Maschito (katund i provincës Potenca)... Ndër fiset e hershme e bujare të Shqipnis shquhen familjet Giura, Muzaku e Kas-trioti ... ". Pas pushtimit Osman, thotë ai - një pjese e popullsisë u larguan dhe zunë vend pikërisht atje ku nuk mbërrin këmba e armikut, i cili është një nga variantet e mundshme të formimit të fshatit Gjuraj, të krahinës së Pultit, dhe prej andej, mundet që gjurajt të kenë lëvizur dhe janë vendos edhe në vende të tjera, përfshi Italinë e Jugut apo edhe Dalmacinë. Pra, me fjalën "Gjuri, Gjura, Gjurra" e kemi në emër, por më shume në toponim dhe mbiemër.

Kështu në këtë analize që i bahet këtij fisi, fisit të Gjurajve na vjen një nder personalitetet e mëdha arbëreshe të një periudhe ma në zë të shndërrimeve të lavdishme italiane, inxhinieri arkitekt, Luigi Giura (Gjura).

3- **LUIGI GIURA**, prej fshatit arbëresh Maschito, pjese e provincës Potenza.

Giura (Gjura) u lind me 14 tetor 1795 prej prindërve Francesco Saverio (Giura) i laruar në doktorate dhe me nëne Vittoria Pascale. Pasi mbaron shkollën elementare në vendlindje, Maschito, vazhdon në shkollën e etërve G. Galazenzio dhe ma vone në Melfi, te dajat e tij në Napoli (Vincenzo Pascale). Në moshën 16 vjeçare ndjek studimet si nxënës i jashtëm në shkollën e konstruktimit të urave e rrugëve, por edhe të punëve hidraulike.

Kështu, me 1817 merr titullin inxhinier i klasit të Pare. Pas formimit të plote profesional, merr disa rrugë neper Evrope për tu njohur me veprat artistike ndërtimore të kolegeve të tij. Me tu kthye prej andej merr përsipër dy pune të rëndësishme inxhinierie të karakterit botëror të pa realizuar deri atëherë në Itali si, urën e varur me elemente hekuri mbi lumin Garigliano (1828-1832), dhe restaurimin e një ure të kohës romake në Abruzzo 1835.

Deri ne vitin 1860, Luigi Giura krijon vepra madhështore si ujësjellës, rrugë, ura, ndërtesa, altarë kisha e të tjera e të tjera. Emri i tij u bë shume i njohur si brenda dhe jashtë Italisë e mbi te gjitha si

njeri me kulture, i ndershëm e plot shpirt njerëzor.

Me 7 shtator 1860 Garibaldi zbarkon në Napoli, ku i jep jete qeverise provi-



zore. Nder të ndriturit me origjine arbëreshe, si: Francesco Crispi e Pascuale Scura, emërohet edhe arbëreshi trete në këtë qeveri Luigi Giura në detyrën e



Ura e projektuar nga Luigi Gjura

Ministrit të Punëve Publike. Garibaldi shpreh opinionin e vet në lidhje me këto emërime si njerëz të ndershëm, profesioniste e me veti të larta morale për t'iu përgjigje emergjencës që kërkonte koha fill mbas përmbysjes së Mbretërisë së Borboneve, ku duhej të lindte Italia e re.

Në këtë kohe i ndodhen tre tragjedi njëra pas tjetrës: i vdes gruaja, Enrichetta Grasso, një djalë, dhe i vëllai Rosario, që ishte azilant në Nica për efekt të bindjeve te tij anti borbone. Në moshën 69 vjeç vdes Luigi Giura, pas një sëmundje të etheve që u quajtën misterioze dhe e pamundur të kurohej nga shkenca mjekësore e asaj kohe. Luigi Giura, vdes me 1 mars të vitit 1864 dhe varrosset në Varrezat Monumentale të Napolit, me një funeral solemn.

\*\*\*

Këta ishin tre bijtë e komunitetit arbëresh me rrënjë shqiptare, që dhanë aq shume për bashkimin dhe ndërtimin e Italisë.

**Përgatiti Ndoc Selimi, Milano**

# DJE MËSUES I DALLUAR, SOT PENSIONIST

Numrit të shumtë të mësuesve pensionist, të cilët dhanë një kontribut të çmuar për zhdukjen e analfabetizimit, në masivizimin dhe zhvillimin e arsimit në Dukagjin e më gjerë, iu shtua këto ditë edhe Palë Bregu, i cili për mbi 40 vjet ishte një mësues shumë i përkushtuar duke shërbyer në fshatra të ndryshme të Dukagjinit si: Lotaj, Vuksanaj, Kaprre, Toplanë, Nicaj-Shosh, Pog, Kir dhe vitet e fundit në Paçram të Nënshkodrës.

Është nga fshati Lotaj i zonës së Shalës, i cili ka nxjerrë figura të shquara në të gjitha fushat e jetës, edhe në arsim, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në historinë e Shalës e Dukagjinit. Kudo që Pali ka punuar e ka karakterizuar përkushtimi maksimal për të justifikuar plotësisht misionin e shenjët që mësuesi ka. Ka pasur një përgatitje të lartë metodike e shkencore, të cilat jua transmetonte nxënësve merr shumë përkushtim dhe për rrjedhojë ata dalloheshin nga të tjerët për cilësinë e të nxënësve. Duke qenë nga natyra shumë inteligjent, këtë inteligjencë përpigje që t'ua transmetonte nxënësve e prindërve të tyre. Kudo ku ka punuar flasin fjalët më të mira për mënyrën e komunikimit, për bashkëpunimin me komunitetin, sidomos nga populli i fshatit Kir të Pultit, ne te cilin punojë për një kohe te gjate, prej 17 vjetësh. Aty shkoj i ri, beqar dhe u bë me familje. U martua me punonjësen e shëndetësisë, Age Nika (Bregu) nga Plani, me të cilën pati 4 fëmijë të mrekullueshëm: Rajmondën, Albertin, Alfredin dhe Aleksandërin.

Vlen të theksohet bujaria dhe mikpritja e tij në Kir, i cili shtëpinë e kishte të hapur në çdo kohë për shaljan, shoshjanë e pultinas duke pasur jo pak shpenzime. Çiltërsinë e tij rrallë kush do ta kishte ne ato kushte jot e lehta, por si, ju përshtat plotësisht shprehjes: "Bukë mirë Kiri".

Ishte pjesëmarrës shumë aktiv i veprimtarive artistike, ne veçanti ne ato jashtë procesit mësimor si drejtues dhe inter-

pretues. Për këtë pat përfunduar dhe një kurs për regjisor ne vitet shtatëdhjetë ne Shkodër, që i dha një ndihmese shumë të madhe. Shquhej në përkrahjen e së resë që në veshje, paraqitje apo mënyrën e jetesës deri në bërjen e një fare oponente me regjimin e kohës.



I priti me shumë entuziazëm ndryshimet demokratike të viteve nëntëdhjetë duke u rreshtuar në krahun e forcave që donin ndryshimin, duke u shquar për objektivizëm. U përfshi ndër të parët në lëvizjet demografike, për një jetë më të mirë e të rehatshme, sidomos për perspektivën e fëmijëve megjithëse asnjëherë nuk e la malli për vendlindjen.

Çifti Bregu, me gjithë punët e shumta, bënë shumë për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre ku frytet e kësaj pune tanimë i kanë marrë, sepse kanë sot fëmijë të shkëlqyer: vajza Rajmonda-punonjëse shëndetësie ndër më të dalluarat në qytetin e Shkodrës dhe tre djemtë shumë të dashur dhe punëtor në strukturat e shtetit ku punojnë. Tamam shëmbëlltërye e babait të tyre.

Duke qenë shumë vital apo siç thotë populli: "me jetue në rrasë të gjallë", ngado që shkoj siguroj një jetesë shumë të mirë duke mos mbete vetëm në varësi të rrogës që merrte në arsim. Pikërisht, puna dhe jeta aktive kanë ndikuar që të duket si një i moshës së dytë me të gjitha shqisat në

parametrat normal duke na çuditë pak që e ka pritë me padurim daljen në pension. Por kur thellohem i japim të drejtë, sepse sot arsimtarët me shumë vite punë nuk e ndjejnë kënaqësinë profesionale si dikur, me shkua në punë për arsye se, nxënësi nuk është siç ka qenë, ka interesim të pakët për mësim dhe nuk është i dhënë për dije. Prindi është shumë indiferent për ecurinë e fëmijës së tij, duke mos i dhënë mësuesit kompetencë të plotë, duke qenë më i dhënë për të kritikuar se, sa për të falënderuar për punën e bërë. As shteti nuk lufton për ti dhënë mësuesit autoritetin që meriton, por i mëshon më tepër lirisë së nxënësve duke e bërë mësuesin shumë të pafuqishëm. Prandaj, kjo kategori mësuesish nuk e ndjen kënaqësinë e punës në arsim, sepse puna nuk e ka rendimentin dhe vlerësimin e dëshiruar.

Është një koincidence shumë e veçantë që dy bashkëshort të dalin njëkohësisht në pension, siç ndolli me Palë Bregun dhe shoqen e jetës së tij Age Bregun. Kjo e veçantë i nxit dy bashkëshortët Bregu që këtë eveniment ta kthejnë në një festë të vërtetë, të cilët për të marrë pjesë në

gëzimin e tyre ftuan me dhjetëra shokë e shoqe, të riñë e të vjetër, me të cilët kanë punuar në vende të ndryshme në arsim e shëndetësi për mbi 40 vjet, dhe që kanë ndarë gëzimet e hidhërimet, si dhe të afërm dhe dashamirës të çiftit Bregu. Kjo ishte dhurata më e mirë që fëmijët e tyre jua bënë prindërve me rastin e ndryshimit të statusit. Ambienti i restorant "Rozafës" u kthye në një mjedis elektrizues nga bisedat dhe muzika. U kthye në një ambient festiv për ta pasur zili çdo lloj dasme. Pra, me daljen në pension bënë një "dasmë" të dytë megjithëse ka kohë që janë bërë gjyshër. Mbrësëlënës ishte ekspozita që mbajti zoti Palë, që është shquar për oratori, ku bëri një përshkrim të jetës së tij si mësues ne te gjitha shkollat ku ka punuar dhe duke falënderuar popullin e fshatrave ku ka shërbyer për ndihmesën që i kanë dhënë në punën e tij. Emocionet ju shtuan sidomos kurë kujtoj kolegët me të cilët ka punuar, por që nuk jetojnë më si: Prelë Bregu, Pjetër Selimi, Fran Beka, Ndue Bregu, Marash Miruku, Mhill Leka, Elez Hasani.

Bukurinë kësaj feste ja shtuan këngët

e interpretuara nga vetë Pali, i cili është shquar tërë jetën në këtë drejtim dhe sidomos alegoria e djemve të tij, të cilët për të festuar me prindërit e tyre, kishin mbërrite nga Suedia, ku ata punojnë e jetojnë. Të gjithë pjesëmarrësit kontribuuan nga pak (sigurisht jo materialisht) duke e kthyer këtë veprimtari në një "dasmë pa nuse".

Për ditë po shtohet numri i mësuesve pensionist, të cilët kanë punuar fshat më fshat dhe larg familjes, por kanë punuar me ndërgjegje e përkushtim duke nxjerrë nga duart e tyre nxënës shumë të mirë e mbi të gjitha njerëz, që një ndër ta është edhe z. Palë. Natyrshëm lindin pyetje: Kush po i zëvendëson këta mësues? Në dorë të kujt po i lënë nxënësit e tyre? Ndoshta Palin mund ta zëvendësojnë ndonjë që e ka marrë diplomën në ndonjë universitet pa ja pa dyert, që nuk din me plotësua regjistrin dhe as çdo të thotë përgatitje ditor, që ka shumë mangësi në të shkruar dhe nuk din as tabelën e shumëzimit. Por, ndoshta e zëvendëson edhe ndonjë mësues që ka mbaruar universitetin publik, i cili ka qëndruar më tepër në kafe se në auditorë, sepse provimet ja ka marrë kuletë e prindërve pa futë asnjë dije në kokë. Sigurisht që ka student që e marrin shkollën me djersë e përpjekje. Pra, me forcat e tyre, por ky nuk ka për ta zëvendësuar Palin apo ndonjë si ky, sepse prindërit i ka me portofol bosh dhe në punë do të futet Ai, i cili shkollën e ka marrë me duar në xhepa. Pra, vajmedet për fëmijët sot në dorë të kujt bien. Pothuajse e njëjta situatë do të jenë edhe për Agen. Ndoshta e zëvendëson ndonjë që ka mbaruar fakultet shëndetësie, por që nuk din as për të qindtat e saj.

Mbetemi me shpresë se diçka do të bëhet në të ardhmen për përmirësimin e cilësisë së shkollës në përgjithësi dhe kjo do të bëhet vetëm duke përmirësuar cilësisht përgatitjen e mësimit dhe duke shëruar shumë plagë që arsimit ka marrë dekadat e fundit.

Rëndësi ka që çifti Bregu e mbylli karrierën me shumë dinjitet, duke lënë kudo fjalën e mirë, tujë kenë shumë gjurmëlënës. Puna e vazhdueshme ka bërë që të gëzojnë shëndet të plotë. Ju urojmë pension të mbarë, të kenë aq vite pensioni sa vite pune me shëndet të mirë e zemër plot si dhe aktiv e vital si deri sot.

**PRELË SHYTANI  
ZEF BARI**

(vijon nga faqe 5) E njëjta gjë do të duhet të thuhet edhe për krahina të tilla aq të rëndësishme të Shqipërisë si Dukagjini, Mirdita, Malësia e Madhe, Himara dhe zona në jug të Bregut të Matës, etj. Ndarja aktuale njëlloj si projekti, mbajnë jashtë Dukagjinit zonën e Nikaj Mërturit dhe pjesë të tjera të Malësisë së Gjakovës që në përgjithësi përfshihen në identitetin kulturor e tradicional Dukagjinas, duke e parapërcaktuar me mohim përfaqësimin e Dukagjinit në Parlamentin Shqiptar nesër. E njëjta gjë mund të thuhet për një pjesë të Mirditës të inkluduar në Mat: Bajraku i Rranzes me Bushkash, Bazi, Ulza. Po ashtu edhe Gjergjani me projektin e ri ka kalua me Pukën, në një kohë që ose mund t'i kalonte Fushë Arrësit, ose Mirditës. Është ruajtur pozicioni i zonës e Vigut, Mneles dhe Vaut te Dejës, në Shkodër, ndërkohë që ai është ekstrem veri-perëndimor i Mirditës etnografike. Malësia e Madhe shqiptare përbëhet nga

Kastrati, Shkreli, Hoti, Kelmendi dhe zona lindore e maleve në lindje të fushës së Postopojës. Ajo është pjesa e Malësisë e mbetur në Shqipëri, sepse pjesa më e madhe e Hotit, e gjithë Gruda, Trieshi dhe Koja ndodhen në Republikën e Malit të Zi. Është e nevojshme kështu rimodelimi i njësive administrative Malësia e Madhe, duke e zhvendosur qendrën në Bajzë dhe kufizimin e saj në vijën Kastrat-Lohe-Reç drejt Vermoshit. Ndërkohë, dalja e qytetit të Shkodrës si njësi më vete administrative, si Qytet Metropolitan, krijon automatikisht: (a) njësinë administrative të Mbishkodrës me kryeqendër në Koplik dhe (b) njësinë administrative të Nënshkodrës me kryeqendër në Bushat, kufiri jugor i së cilës do të përfshijë sigurisht edhe Sapen inkluziv. Kjo zhvendosje më pas kërkon rimodelime në Lezhë, në Breg Matë, në Kurbin dhe deri në zonën bregdetarë në Rodon, varësisht përkatësie etnografike dhe njësive ekonomike.

Pamundësia konstante e shtetit shqiptar për të ndërtuar përfaqësimin institucional politik, që do të lehtësonin ushtrimin e mirëfilltë të integritetit territorial shtetëror dhe mundësonin gëzimin e lirisë për regjionet (në Jug, por edhe në Veri), me specifika etnike dhe religjioze do të duhet të konvertohet me projektin e ri në të kundërtën, d.m.th. në krijimin e përfaqësimeve adekuate, përmes ndarjeve logjike historike dhe antropologjike, që i paraprijnë kolegjeve të nesërme elektorale të arsyeshme dhe përfaqësimit në liri, në organin sovran të kombit Mbi të gjitha, shteti shqiptar do të duhet të dëshmojë njohjen në vijimësi të përfaqësimeve të efektshme dhe të përshtatshme në të gjithë piramidën e nënpiramidën shtetërore të veçantive të popullsisë mbi të cilën ushtron de jure sovranitetin. Rasti i Mirditës, i ndarë në pesë rrethe administrative; dhe shkatërrimi nëpër zona të ndryshme elektorale i bashkësive me

interesa përfaqësimi të njëjta, Himarës dhe Bregut në tërësi, Dropullit dhe Vurgut, do të duhet të marrin fund një herë e mirë, në të mirë të tregimit se jemi një shembull i procesit evropianizues, shembull i lirisë politike dhe civile, që dimë të kapërcejmë ngërçet e krijuara nga ngurtësia e njohjes së realiteteve tona të brendshme. Drejtuesit e politikës shqiptare që kanë marrë përsipër të reformojnë strukturën administrative, duhet të dëshmojnë se janë njohës të mirë të popullit të vet, Shqipërisë zyrtare dhe asaj reale. Ky është testi që i mban ata në këmbë. Përndryshe, projektuesit teknikienë të reformës administrative kanë dëshmuar të kundërtën: janë pa njohuritë e nevojshme në histori, antropologji, gjeografi regjionale dhe në të drejtën administrative evropiane. Ndaj qeveria do të duhet t'i ndalë ata nga vijimi i mëtejshëm i punës mbi këtë bazë të pamjaftueshme teorike dhe metodologjike.

# NËNË TEREZA

Si sot 104 vjet me pare lindi Nena e gjithë botes, shqiptarja Anjez Gonxhe Bojaxhiu, Nene Tereza. Humanistja fituese e çmimit Nobel për Paqe (1997). Krenaria e Nacionalitetit Shqiptar. Lum ne që e kemi!

Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, e njohur si Nënë Tereza, lindi në Shkup më 26 gusht të vitit 1910 dhe vdiq më 5 shtator 1997 në Kalkuta, (Indi). Ishte humaniste e njohur shqiptare, fituese e çmimit Nobel për Paqen.

Lindi në Shkup, të Shqipërisë te pushtuar prej Perandorisë osmane, sot Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, më datë 26 gusht 1910. Një ditë pas lindjes u pagëzua në kishën e Zemrës së Krishtit nga famullitari i atëhershëm, Dom Zef Ramaj, ditë të cilën ajo e llogariste si datëlindjen e saj. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut me origjinë nga Mirdita dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës. Kola dhe Drania patën 5 fëmijë, dy nga të cilët u vdiqën në fëmijërinë e hershme. Frikë të madhe kishte nënë Drania se mos Gonxhja i vdiste menjëherë pas lindjes, sepse me trup dhe shëndet dukej e dobët. Gonxhja kishte një vëlla dhe një motër. Vëllai quhej Lazër Bojaxhiu dhe studioi në Grac të Austrisë në Akademinë Ushtarake, por për shkaqe politike emigroi qysh herët në Itali, kurse motra quhej Age Bojaxhiu. Babai i saj merrej me tregti dhe mblidhte në shtëpinë e tij artistë dhe patriotë shqiptarë. Shkupi i merret Shqipërisë

prej Maqedonisë me 1 Janar 1918 në bazë të traktatit të Versajës. I ati, që ishte i përfshirë në lëvizjet politike e asaj kohe, vdes në 1919 kur ajo ishte 8 vjeçe. Gonxhja mësimet e para i mori në një shkollë shqipe në Shkup, po ashtu e kreu dhe gjimnazin, por në gjuhën serbo-kroate. Pasionet e rinisë së Gonxhes ishin tre: të bëhej mësuese, të shkruante dhe recitonte poezi dhe të kompozonte e të luante muzikë. Emrin «Tereza» e mori kur ishte 18 vjeçe dhe u dorëzua murgeshë.

Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, Irlandë. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë. Më 12 shtator 1928, Gonxhja kishte shkruar këtë letër drejtuar tezes së saj:

*"Shkup 12. 09. 28 E dashura Teze Lis! Më 26 të këtij muaji po nisem prej Shkupit. S'po mund mos me ju shkruaj dy tri rreshta për juve. Lamtumirë, e dëshiroj që Zoti t'ju nap gjithshka që ju deshron zema. Dua t'ju fal gjanat ma të përzemërta, Gonxhja".*

Ky ishte momenti kur ajo u nda përfundimisht me familjen dhe vetëm pas 30 vitesh, do të takohet me të vëllanë,

Lazrin. Kurse nëna Drania dhe motra Age, shkuan në atdhe, në Shqipëri, qysh para Luftës së Dytë Botërore. Nënë Tereza u vendos në Kalkuta (Indi) ku fillimisht u bë mësuese dhe shumë shpejt drejtore e shkollës së vajzave. **"Nënë Tereza e Kalkutës"** u quajt kur themeloi urdhrin **"Misionaret e Dashurisë"** (1951) për t'u shërbyer më të varfërve dhe më të pashpresëve të Kalkutës, Indisë dhe gjithë botës. Në vitin 1979, kur mori çmimin Nobel për Paqe, e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Haste vështirësi



për të folur rrjedhshëm Shqip pas një largimi prej 70 vjetësh dhe qëndrimi në ambiente joshqiptare, por ajo kurrë nuk e ka mohuar origjinën e saj shqiptare. Shkrimet e saj ne Shqip janë letrat e rinisë dhe më pas me familjen në Shqip, përsëritje në Shqip popullit shqiptar pas fitimit të çmimit Nobel me 1979 dhe lutja në Shqip transmetuar nga Zëri i Amerikës me 17 Qershor 1978. Në çastin e marrjes së Çmimit Nobel më 1979, një nga klerikët që merrte pjesë në sallë e pyeti Nënë Terezën se, nga ishte. Ajo deklaroi: **"Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri"**. Por Shqipëria heshte! Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i kishte dhënë vizë nobeliste së ardhshme as sa për të parë nënën e saj që jetonte në Tiranë, as për të marrë pjesë në varrimin e saj më 1974, as për të parë varrin. Madje këtë vizë nuk ia dhanë as kur fama e saj kishte marrë dhenë në të katër anët e botës deri ne fillim të viteve '90. Shqiptarja trupvogël ishte kthyer në një legjendë të gjallë!

Deri sa Nënë Tereza ishte gjallë dhe sot e kësaj dite shifrat kanë ndryshuar shumë.

Nënë Tereza nuk qe ndonjë perëndeshë dhe me të mund të fliste çdonjëri. Madje ajo kishte edhe adresë të saktë: një godinë ngjyrë hiri në Bose Road, të ndërtuar në një lagje të zhurmëshume dhe çjerrëse, të stërmëshur me njerëz, e cila vlonte nga çajbërësit, shitësit dhe tregtarë të tjerë të pjesëve më të ndryshme këmbëse si dhe lëngështrydhësit. Këtu, mu në qendër të Kalkutës shtrihej shtabi i përgjithshëm i Rregullit, «Shtëpia e Nënës», pranë portës të së cilës qe vendosur një tabelë druri ku shkruante: **«Mother Teresa. IN/OUT»**. Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si mbretëresha e Britanisë, ish

presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush e Jimmy Carter, Yasser Arafati, prince-sha Diana e shumë të tjerë. Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare, humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve, sidomos në zemrat e shqiptarëve. Kur ishte e re jo vetëm ka folur, por ka shkruar edhe poezi ne gjuhën Shqipe. Për shembull poezinë e ka shkruar kur ishte 22 vjeçe gjate udhës pre ne Indi. Sot kemi një dëshmi të Nënë Terezës që flet shqip më 1988, në një intervistë dhënë Zërit të Amerikës në gjuhën shqipe.

Nënë Terezës, për të ardhur në Shqipëri iu desh të dërgonte tre letra. Ajo i kishte dërguar më parë letër Komitetit

Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, por nuk mori kurrë përgjigje. Ja se si e shpjegon Lolja letrën e te madhes Nena Terezë dërguar Presidentit te Republikës ne vitin 1989, te cilit i theksonte se: *"... për 60 vjet kam vizituar shume e shume vende jashtë atdheut tim ..."*, qe është edhe një fakt se ajo e konsideronte Shqipërinë atdheun e saj. Me ne fund, e para pasaporte (për këtë rast ishte diplomatike) e dhenë pre nënshtetas te huaj me origjinë shqiptare, iu dha pikërisht Nënë Terezës, e cila vizitoi Shqipërinë me 1989. Nënë Tereza kishte gjithashtu pasaporte nga India, Vatikani, Britania e Madhe dhe Italia. Kur i thane për pasaportën Shqiptare ajo u përgjigj: *"E pranoj me kënaqësi, sepse është pasaporta e vendit tim; atje kam Nënë dhe motrën, atje kam miq e te njohur, atje shume shpejt do te hapim misionin tone e unë do te jem vete aty..."*. Kur mori çmimin Nobel, ne vitin 1979, amerikanet i ofruan nënshtetësinë amerikane dhe pasaportën, por ajo nuk pranoi.

Nënë Tereza u bë një nga urat ndërldhëse të njohjes së shqiptarëve në botë. Bill Clinton është shprehur në qershor

2002: *"Nënë Tereza, ishte e para Ajo qe më bëri ta dua kombin shqiptar. Dhe tani ndihem shume krenar që plotësova një detyrë morale ndaj saj dhe ndaj vlerave te lirisë..."*. Por origjina shqiptare nuk duhet absolutizuar. Duke qene shqiptare Nënë Tereza nuk i përket vetëm Shqipërisë, guaska etnike do ta kufizonte. Gonxhja u be qytetarja e botes, e popujve, feve dhe e qytetërimeve. Ne vitin 1950, ajo themeloi urdhrin e saj te murgeshave te quajtur Misionaret e Bamirësisë, qe i shërbejnë tërësisht te varfërve. Shqiptarja trupvogël ishte kthyer ne një legjende te gjalle. Vetëm sipas te dhënave te vitit 1980, ajo ishte kujdestare e 7 500 fëmijëve ne 60 shkollat, mjekonte 960 000 te sëmurë ne 213 spitale, ishte e vetmja ne bote qe trajtonte 47 000 viktime te lebrozes ne 54 klinika, kujdesej për 3 400 pleq te braktisur e te lenë rrugëve ne 20 shtëpi pleqsh dhe kishte birësuar 160 fëmijë jetime. Nder titujt qe i janë dhenë Nënë Terezës përmenden: Pamada Shir; Gjoni XXIII për Paqe, te cilën ja dorëzoi personalisht Papa Pali VI; Samaritani i Mire, ne Boston; Shpërblimi Ndërkombëtar John Kennedy, ne Uashington; Nena e te Gjitha Nenave, Balzan; Çmimi Nobel për Paqen; Medalja e Lirisë, shpërblimi me i larte amerikan; Medalja e Paqes, shpërblimi me i larte i Rusisë; etj.

Me 5 shtator 1997: bota mësoi se Nënë Tereza ( Angel of Mersy) vdiq ne moshën 87 vjeçare duke lenë pas dashuri. Ndërkohë ne Maqedoni është botuar një monografi se Nënë Tereza është maqedonase!!! Një gjë te tille dëgjova një dite edhe Alsat për origjinën/dyshimet dhe spekulimet qe i bëjnë te tjerët lidhur me origjinën e saj. Sipas gazetës "Washington Post", 16 Tetor 2003, deklarohet qarte se Nënë Tereza ka lindur ne Shkup, ne kohen kur nuk kishte FYROM dhe Shkupi është qytet i perandorisë Otomane. Me tej rithuhet fjala e Nënë Terezës, qe sipas gjakut ajo është Shqiptare. Gjithashtu, gazeta shkruan se vëren qe kaloi një skulptor sllavo-maqedonas krijoi një shtatore te Nënë Terezës, me mbishkrimin thjeshte si një bije e Maqedonisë, për ta dërguar ne Rome me rastin e saj te shenjtërimit. Por, zëri i bashkuar i Shqiptareve ne lidhje me origjinën Nationale Shqiptare te Nënë Terezës beri qe ai skulptor ta harronte ëndrrën qe pati. Para meje kam librin e Kathryn Spink i përkthyer ne gjermanisht dhe biografia është e autorizuar nacionalist shqiptar i cili angazhohej për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe krijimin e Shqipërisë se Madhe, për këtë ai kishte shkruar ne Beograd tok me konsullin italian. Kishte shkruar atje me një shëndet shume te mire dhe u kthye prapa i shtrire për vdekje. Ai i kishte 45 vjet kur vdiq. Mjeku dhe anëtarët e familjes ishin te bindur se Nikola ishte helmuar ne Beograd. Janë shkruar e shkruhen edhe sot e kësaj dite me qindra vepra për te madhen Nena Terezë, por te gjitha flasin ne te vërtetën se, ajo ishte shqiptare, siç e ka deklaruar edhe vete.

Nena Terezë vdiq me 12 shtator te vitit 1997, tani ne vitin e 104 te lindjes se saj krenohemi për jetën dhe veprën e saj.

**Përgatiti Frasher Racaj, Peje**

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi

**DUKAGJINI BANE ËMËN**

Më fal o Dukagjin im  
Për ty mora shqetësim  
Pata goditje në shpirtin tim  
Të pyes, mos jam gabue?  
Se jam tujë ndigjue  
Emënin donë me t'a gjymëtue  
Me të tjerë me t'tjetërsue  
Po mendojë për ditë  
Ky simbol s'duhet goditë  
Ati shekujt i dhanë dritë  
Fitue që në kohë t'lashtë  
Të thanë Princ i art  
Pse me t'paragjykie me hile  
Ketë pagëzim e ke që kur linde  
E mbajte me qëndresë e lavdi  
Të skalitun me gjak të ri  
Madhështinë t'a njofti bota  
Për trimënit në lufta t'forta  
Në shekuj u ndërgjegjësove  
Fitove forcë e kulturë shpirtërore  
Me vlera të mëdha mendore  
Ligjin madhor formulove  
Me emën Kanu u pagëzove  
Me dekada jetoi dhe u zbatue  
Dhe jashtë vendit u vlerësue  
Ai malësisë i dha lavdi  
Dukagjinit në veçanti  
U ba pjesë e vlerave të kombit  
Sistemoi problemet e motit  
Prandaj kurrë mos të preket  
Se atëherë vlera i tretet  
Në flamur qëndron i shkruie  
Me gjakun tonë të kullue  
Po mendohet si ma zi  
Do mendimtarë si "kalemëxhi"  
Me të vra t'bardhën histori  
Me ruejt vlerat e "buxhetit"  
Në dëm të popullit, e në favor të vetit  
Mos-njohja tregon mangësi  
Për studiuesit në histori  
Kjo mund të kuptohet si fatkeqësi  
Si cungohet historia  
E shkruhet pa saktësi  
Me shumë armiq je përpjekë  
I ktheve malet në qëndresë  
Shekujt të dhanë forcë e qëndresë  
Bane emën në situatë të ashpra  
Luftë me petica, huta e shpata  
E armë të shkurta e të gjata

Në luftë more aftësi e dituri  
Vendin e majte në liri  
Fe e besë kurrë si ndryshove  
Në shekuj besnik u qëndrove  
Kjo ishte merita jote  
Që e ruajte në mote  
Roje i qëndrove vatanit  
Në arshivat e Vatikanit  
Me randësi i ruhet vlera  
Në Evropë ndër muzena  
Në Amerikë e Australi  
Të ruejtën vlerat si stoli  
Emëni yt në Botë njihet  
Në çdo kohë vlera i rritet  
Dituri e guxim fitove  
Brezave dorë në dorë i kalove  
Mos të kap dyshimi  
Ty s'të bien vlerësimi  
Se emën Dukagjin  
Për jetë do ketë nderim  
Unë që po shkruaj e shumë tjerë t'vëndit tim  
Që jetojnë në emigrim  
Kur del emëni Dukagjin  
Marrim vlera e nderim  
O malësia ime, je nanë e madhe  
Shumë trime e bujare  
Në shpirt e mëndje t'kemi të shkruie  
Gjithmonë me të respektue  
Me shpirt e me zëmër  
Të lavdishmin emën  
Në emigrim mëndja na këshillon  
Me mallkue atë, që të mohon  
Ai kurrë nuk tjetërsohet  
Në shekuj do të nderohet

**Pjetër Geraj,**  
**Belgjikë,**  
**Gusht 2014**

**A T D H E U**

Atdheu është  
Babë e nënë  
Tokë e bekuar  
Aty më mirë  
Dielli ngroh  
Me rrezet e tija  
Hëna shndritë  
Me plot shkëndija  
Era ka aromën  
E këndshme,

Uji shijen –  
të mirë se në  
Çdo vend të huaj  
...  
Ku do që jemi  
Të duam Atdhe  
Në mendje e zemër  
Të kemi... gjithnjë,

**PERLAT BREGDETARE SHQIPTARE**

Bukuritë detare mund ti hasësh  
Vetëm në bregdetin shqiptar  
Me plazhe të virgjëra

Fillon me Ulqin e Tivarë...  
Deri në Sarandë e Himarë

Janë edhe në Durrës, Vlorë  
Shëngjin, Velipojë...

Perla magjepse tokësore  
Hasesh vetëm në atë pjesë  
Të Adriatikut e detit Jon  
Si evenimente shqiptare  
Të lakmuara nga fqinjët  
Gjithmonë

**TUNELI I KALIMASHIT**

Të përshkon pjesën e rrugës më të re  
Që lidh dy shtete shqiptare  
Është vërtetë kënaqësi  
E tuneli i Kalimashit  
Një tjetër mrekulli

Të pinë kafënë e mëngjesit në Prishtinë  
Drekën e pushimin në Tiranë  
Darkën duke pirë ujë në Shatërvan  
Për një ditë fare pa u lodhur  
S"do koment  
Dikur ëndërr-  
Tani e mundur

**VENDLINDJA IME**

Ashtu si thonë ka vendos perëndia  
Sikur edhe e paskam pas fat  
Në këtë botë më solli "dallëndyshja"  
Jo në qytet po në fshat  
Kështu edhe "folenë" e parë  
Ma kishte përgatit gjyshja  
Aty është vendlindja ime

Emri i sajë më shoqëroi  
Kudo që shkova nëpër Atdhe e Evropë  
Vendlindja nuk më ndryshoi  
Ashtu do të mbetet  
Deri sa të jem në këtë botë  
E do ta mbaj me vete  
Ngado që të shkoj  
Në intimitet

**LUMËBARDHI I PRIZRENIT**

Fillon burimin diku lart në mal-  
Ujitë rrënjët e kalasë së vjetër  
Nga shushurima e ujit  
Duke lëvizur në shtratin gurë-gurë  
Përhapet një zhurmë  
Melankolike valë-valë

E zbukuron qytetin  
Freskon ajrin e ambientin  
Bashkohet me Drinin  
Të rrugëtojë për në Shqipëri  
Sikur i kujton proverbin  
Njeriut të kësaj toke, se  
"Vetëm bashkimi bën fuqi"

**Nga cikli poetik**  
**"ATHEU VENDI ME I BUKUR!",**  
**të poetit Beqir M. Cikaq**  
**Gusht, 2014**

**NANA**

Në çdo dallgë të jetës  
në çdo hall e mërzi  
ti për vete s'u ankove  
por gjithmonë pyete:  
"Ajenimirë fëmijët e mi?"

Nanë, kush mundet më të vlerësue  
ti je madhështore  
ti je krenari  
ti je hyjnore  
ti jep dritë e falë dashuri.

Atje në Parajsë, ku tije,  
shpirti yt, lutet për ne,  
lutesh Zotit për paqe e mirësi,  
që njerëzit në tokë të jetojnë  
me paqe e dashuri

**Ndue Mici, Korrik, 2014**



# Nga historia shqiptare e Anadollit dje...

Kur njeriu flet për Turqinë, mendja të shkon te pllaja e Anadollit. Ajo ka qenë e populluar që nga të mugëtit e historisë së njerëzimit, por dhe vazhdimisht ka qenë një shesh e arenë lëvizjesh të popullatave të ndryshme të ardhura nga gadishulli Ilirik, Kaukazi, Azia Qendrore apo dhe nga Mesopotamia e Lindja e Mesme. Megjithatë një popullatë që e rrënjës, mbeti e nuk u zhduk kurrë me gjithë stuhitë e kohërave; si në lashtësi e në mesjetë dhe në kohën e re e të sotme, zotërite edhe sot të vërtetë të Anadollit, të Thrakës e të mbarë Turqisë, fisnikët e saj, pikërisht elementi shqiptar: Pellazgët, ilirët, të ashtuquajturit rumë, që mbizotëruan gjatë mesjetës e deri në ditët tona, madje në dy formacione shtetërore të mëdha si Perandoria Bizantine dhe Perandoria Osmane. "Hirushja" e vatrës, siç e quan Robert D' Anzheli gjuhën shqipe, mbeti pjesë e pandarë e jetës së banorëve të Anadollit. Asaj gjatë viteve të zotërimit bizantin u shtua gjuha greke si gjuhë kulture, e kishës dhe gjuhë zyrtare e perandorisë për 10 shekuj dhe më pas gjuha osmanishte për 6-7 shekujt e fundit deri në ditët tona. Pra pati një shtresëzim 3-4 gjuhësh në shekuj, megjithatë shqipja u mbijetoi valëve zemërake të qindvjeçarëve. Rastet e saj i kemi gjetur të gjalla në Ishujt Prinkipo apo të Princave në Stamboll, ku popullsia vendase ndonëse shkollimin e ka bërë në greqisht, por edhe në turqisht, shqipen çuditërisht e ka ruajtur si gjuhë shtëpie. Dikush mund të shtrojë pyetjen e ligjshme: Shqiptarët janë autoktonë në Turqi, në Anadoll?! Por e vërteta e shekujve është kjo. Një marrëveshje e Lozanës në 1923-25 prishi konfiguracionin e popullatave në të dy krahët e Detit Egje. Është thika më e madhe që i është ngulur ndonjëherë pas shpine popullit shqiptar pas kohës së Lidhjes së Prizrenit dhe të shpalljes së Pavarësisë më 1912. Më 1877 e 1878 në gjenocidin e egër të dy dimrave të shtetit shovinist serb mbi sanxhakun shqiptar të Nishit, u larguan me dhunë nga trojet e tyre të lashta mbi 300.000 shqiptarë myslimanë; pas vendimit barbar të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913 për masakrimin e territoreve shqiptare të Kosovës e Çamërisë në favor të fqinjëve grabitqarë e të pangopur, që u pagua me koston e vuajtjeve të paimagjinueshme dhe të dëbimit të përbindshëm nga vendi i tyre të disa qindra mijëra vetëve prej tyre në vitet e rënda të luftës së parë botërore. Me marrëveshjen e Lozanës dhe atë që e pasoi më pas, largimin e pamëshirshëm nga shtëpitë e tyre, duke lënë edhe tenxheren e gjellës duke vluar në zjarr, u shkëputën nga vendbanimet e tyre stërgjyshore që nga antikiteti, jo pak por mbi 2 milionë banorë të të dy brigjeve kundruall të Egjeut për të "prodhuar" mbi bazën e përkatësisë fetare me shqiptarët myslimanë – "turq" dhe me shqiptarët ortodoksë "grekë" dhe për të zhbërë përfundimisht nacionalitetin e tyre shqiptarë. Kështu deshë Evropa, kështu deshën edhe dy shtetet nënshkruese të marrëveshjes, Greqia dhe Turq-

ia. "Kurbani" i marrëveshjes në një rëndësi anë qenë arvanitët myslimanë të Moresë (Peloponez) dhe çamët myslimanë si dhe shqiptarët muhamedanë të Maqedonisë "greke", të ish-vilajetit të Selanikut dhe të Thrakës Perëndimore. Ndërsa në krahun tjetër qenë rumët, kryesisht shqiptarë dhe llazët ortodoksë që u këmbyen si kafshë në pazarin e bagëtime midis dy shteteve, ndërsa Evropa bënte "sehirin" e radhës të veprës makabre të vet, duke luajtur me fatin e tij, pra në kurriz të popullit shqiptar.

Pra, pas Berlinit më 1878, Londrës më 1913, si edicioni i tretë, Evropa plakë i vuri vulën me Traktatin e Lozanës të 1923-24, si akti i fundit i tragjedisë që i kish përgatitur popullit më të madh e më të lashtë të kontinentit për ta shuar përgjithnjë nga faqja e dheut...Kështu i ndërrouan në bazë të fesë gati gjysmë milion myslimanë, kryesisht shqiptarë të Greqisë, me mbi 1, 5 milion të krishterë shqiptarë të Anadol-

lit, të perëndimit, të jugut, të qendrës e të veriut të tij; por në këtë të fundit pra, në veri të Turqisë, në pjesën lindore të Detit të Zi, përfshihen edhe të krishterët llazë, një popullsi autoktone, me prejardhje pellazge, e afërt me shqiptarët në tradita, në zakone, në gjuhë, në folklor, në këngë dhe valle, në veshje, në kulturë, në arkitekturën e shtëpive, në artin e detarisë e të tjerë. S'mund t'i kapërcej këto rreshta, pa thënë dy fjalë për komunitetin shqiptar të rumëve të Izmirit, që pas Lozanës u shumëzua me zero. Ishte një komunitet shqiptarësh ortodoksë që ka luajtur rolin e një lokomotive progresi në Perandorinë Osmane. Ata kanë qenë mjeshtër të tregtisë në perandori, në fillimet e industrisë në Turqi, ata kanë investuar kapitalet e tyre në Izmir e zonën përreth deri në Stamboll, në kryeqytet, kanë dhënë një ndihmesë të shkëlqyer në fushën e arsimit, kulturës e të tjerë. Atyre u takon merita e nxjerrjes në gjuhën frënge të gazetës "Smyrna", gazetë e parë otomane. Sa keq që ky komunitet i lavdishëm që ka qenë në

harmoni të përkryer me shqiptarët myslimanë (si kudo shqiptarët me njeri tjetrin, pavarësisht nga besimi fetar apo besa siç është thënë ndryshe dikur) u dëbua me Lozanën. Edhe ikja apo dëbimi i tyre ka qenë i dhimbshëm e i llahtarshëm. I bartën me anije të huaja për në Greqi. Ndodhi afërsisht si largimi bibliki i shqiptarëve nga Shqipëria më 1990 me anijet shqiptare "Vlora" e të tjera. nga Durrësi, që u mbushën sa s'kishte ku të hidhje mollën dhe u kacavirren në to, por në rastin që po flasim ishin shumë e shumë më tepër, s'ka vend për krahasime. Shqiptarët e Izmirit jo me qindra po me mijëra përfunduan të mbytur në ujërat e ftohta të brigjeve të Izmirit. Thirrjet dhe lebetitjet e këtyre njerëzve deri në kupë të qiellit, që u lanë në mëshirë të fatit, s'ka penë që t'i përshkruajë. Rastet e tyre i gjen edhe sot në Katerini, një lokalitet afër Athinës. Autori i këtyre rreshtave ka njohur personalisht dy zonja të nderuara



nga ky komunitet. Njëra me emrin Zefirat (shkurt Zefina), që jetonte në Athinë dhe punonte në bibliotekën shtetërore të saj, ndërsa e dyta ka punuar në Radio Tirana, në radion e jashtme. Shqiptarët myslimanë të Gjirokastrës, të Delvinës, Konispolit e Çamërisë poshtë lumit Kalama kanë jetuar në shekuj në Izmir. I tillë p.sh., në vegjëli, ka jetuar shkrintari e përkthyesi i shquar Vedat Kokona. Veç historia e shqiptarëve të Izmirit është sa e dhimbshme aq edhe të bën krenar për bashkënationalitetin tanë vendas të atjeshëm. Duhet studime e studime të tërë që të ndriçojnë këtë pjesë të nacionalitetit tonë, që ka jetuar në këto hapësira që nga lashtësia po që i takon tashmë historisë. Rastet e tyre në Greqi, pothuajse janë greqizuar plotësisht...

Në këtë truall, që quhet Anadoll, kanë jetuar jo vetëm popullsi të stërlashta si sumeret e hititet, me të cilët fillon historia e njerëzimit apo edhe pellazgët, por edhe gjatë mijëvjeçarit të I para L K, dhe në shekujt e tij kanë banuar në të, në pjesën më të madhe të tij, popullata ilire,

atë të Anadollit apo Anatalisë. Pjesën më të madhe të territorit të këtij të fundit e zinte fisi i frigasve që ka pasur shtetin e vet të centralizuar, një mbretëri që sundoi për rreth 7 shekuj gati në mbarë Anadollin. Rilindasi arvanit, Aristidh Kola, duke pasur parasysh që Anatalia ka qenë rrënjë e shqiptarëve, në një poezi hymn të tij shkruan midis të tjerash se "ty kush mund te të presënj, kush mund te të zhdukënj, rrënjë e lashtë e Ilirisë, e Pellazgjisë, rrënjë e lashtë e Anatalisë".

Popullsia pellazgo-ilire në antikitetet vazhdoi rrugëtimin e saj në mesjetë si të ashtuquajtur "rumë", (jo në kuptimin grek, por si ish-banor i perandorisë romake e më pas bizantine). Ajo u mbijetoi valëve të egra asimiluese nga popullatat barbare që shkelen Anadollin, por që zunë e nuk zunë vend aty. Pas mijëvjeçarit të parë të L K, aty u vendosen fiset e turqve selxhukë, për t'u pasuar në shekujt e XIII, XIV, XV nga turqit osmanë. Në shekujt e mesjetës, duke filluar nga shekulli i pestë, kur merr rrugën Bizanti i perandorit Justinian i Parë, popullsia

vendase e genit pellazgo-ilir, pra rumët që flisnin shqip (në Ballkan kanë përballë apo në kontinuitet, arbitrit mesjetarë), ngritën qytete të tëra të nëndheshme në pllajën anatolike, për të jetuar. Turisti i sotëm mbetet pa mend, kur viziton këto qytete apo vendbanime të nëndheshme dhe bën çudi si janë ndërtuar ato dhe si mbijetoi popullsia "arbre" (rume) në to. Sigurisht duke qenë e njëjta popullsi që themeloi edhe qytetin e Bizantit (Konstantinopojës apo Stambollit) në një pikë strategjike midis dy gadishujve, djep i qytetërimit evropian e mesdhetar në ngushticën e Bosforit, njeriu nuk mund të mos habitet me vitalitetin e saj. Ajo u mbijetoi shekujve të pamëshirshëm dhe mirë apo keq e ruajti shqipen. Historiani shqiptar, Prof. Kristaq Prifti, në një monografi për Ibrahim Temon na tregon se jo vetëm në vilajetin e Selanikut, që ishte me popullsi kryesisht shqiptare, por edhe vilajeti i Edrenesë në fund të shekullit 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të rreth gjysma e popullsisë së tij fliste shqip dhe përbënte masën kryesore të tij. S'po flasim për qytetin e Stambollit që deri në vitet 70 të shekullit 20-të sipas një statistike të brendshme të bashkisë së tij nga 140.000 banorë ortodoksë, 100.000 prej tyre flisnin ende shqip dhe deri diku, ndonëse jo si në shekullin e mëparshëm luanin një rol me influencë në jetën e Stambollit e sidomos përbënin një pjesë të konsiderueshme të elitës së tij. Aq e vërtetë është kjo, sa edhe në shoqatën turko-shqiptare d.m.th. të shqiptarëve të Stambollit e të krejt Turqisë, ata luanin rol vendimtar, madje i jepnin asaj tonin. Pas grushtit të shtetit (apo "darbe"-s siç thuhet turqisht) në fillim të viteve 70 dhe ndjekjeve që bënë ndaj tyre sigurisht ra dhe influenca në Shoqatën shqiptare.

Kur flasim për shqiptarët e Turqisë nuk duhet të harrojmë tre komponentë, atë autokton, atë të ardhur dhe në këtë elementin mysliman shqiptar, që mbushi Thrakën Lindore dhe Anadollin, për dy shekuj në vazhdimësi, në qindvjetshin e 19-të dhe atë të 20-të me shqiptarë kryesisht të besimit islam. Stambolli deri në fund të shekullit të 19-të, 2/3 e popullsisë së tij i ka pasur të besimit të krishterë. Lagje të tilla si Feneri (apo Fanari), Balata, Tarlabashë, Pera, Bejollë, Tophane, Beshiktash, Arnavutqoj, Shishli, Maçka, Teshvikije, Etiler, Bakerqoj, Kadiqoj, Bostanxhi, Suadije, Fëndekzade, Koxha Mustafapasha (ose Samatia) e të tjera, sidomos lagjet buzëdetit gëlonin, gjallonin nga të krishterët. Ato kanë pasur dhe emrat e tyre të vjetër që popullsia e Stambollit në zhargonin e sotshëm të folur, sidomos të vjetrit, i kujtojnë me nostalgji dhe sjellin ndërmend se në ç'harmoni shembullore kanë jetuar me kristianët rumë dhe miqësitë që kanë pasur me ta.

Stambolli apo edhe Konstantinopoja siç quhej atëherë, si kryeqytet, ka qenë metropoli që ka grumbulluar popullatat nga tërë anët e Ballkanit, Kaukazit dhe Lindjes së Afërt e të Mesme. Gjithmonë në përbërjen e kryeqendrës osmane elementi dominues i popullsisë së saj kanë qenë shqiptarët, qoftë të besimit mysliman apo atij kristian. Rreth 80 kishat ortodokse të Stambollit, (përfshi dhe

Kishën e Shën Triadhës në zemër të tij, në sheshin Taksim në Bejollë bashkë me liceun e vajzave në krah të saj, të ndërtuar që më 1874 nga pasaniku i madh shqiptar Vangjel Zhapa nga Labova e Kryqit në Gjirokastër), janë kisha të ndërtuara nga shqiptarët e që në shekuj u kanë shërbyer atyre dhe vetëm atyre, të njohur si rumë të vendit, autoktonë denbabaden, që nga mugëtitrat e Bizantit e thellë e më thellë...

Nuk mund ta mbyll komponentin e parë autoktone pellazgo-iliro-rume, pa përmendur tre ç'vendosje të mëdha popullatash të genit shqiptar në tre kohë të ndryshme, në antikitet me Aleksandrinë e Maqedonisë, në mesjetë në kohën e Gjergj Kastriotit dhe në kohën tonë, nga çereku i parë i shekullit të 19-të e deri tani në fillim të mijëvjeçarit të ri. Stambolli dhe Anadoll pavarësisht kufijve të çdo kohe, kanë qenë forca tërheqëse magnetike e shqiptarëve, sidomos nga Ballkani. Një ç'vendosje e madhe ka qenë lëvizja e trupave të Aleksandrit të Maqedonisë nga Ballkani kur ndërmori fushatën e madhe luftarake deri në Indi. Masa të mëdha njerëzish të racës sonë u ç'vendosën e u vendosën që nga malet e Hindokushit, në Kaukaz e në vet Anadollin e deri në Egjipt, ku u formua qyteti Aleksandria dhe në Anadoll në brigjet e Mesdheut, qyteti Iskenderun (Aleksandria e dytë) e të tjera.

Në kohën e Gjergj Kastriotit, në shekullin e XV, pas vdekjes së tij e pushtimit osman, 300 000 shqiptarë, shumica luftëtarë bashkë me familjet e tyre të mëdha, kapërcyen detin e u vendosën kryesisht në jug të Gadishullit Apenin, në Kalabri e Siçeli. Disa dhjetëra mijëra të tjerë kapërcyen Danubin dhe kaluan në Rumani. Por, emigracioni më i madh ka qenë i brendshëm, drejt "nuklit", në thellësi të Perandorisë Osmane, drejt Stambollit e Anadollit, rreth një milion njerëz. Llogarisni që ka qenë një ç'vendosje e stërmadhe nga hapësirat e Ballkanit, "apokaliptike" do ta quaja për kohën që çoi në boshatisje të tokave, ku rrinin shqiptarët, të cilët u bënë dhe rezistencën më të madhe pushtuesve osmanë. Mendoni, që në ato kohëra popullsia e botës ka qenë tepër, tepër e vogël dhe e rrallë në krahasim me sot, kështu që shifra prej 1 milion shqiptarësh apo më mirë të themi arbrish që ia mësynë Anadollit ka qenë tepër e madhe dhe s'mund të krahasohet me 1 milion njerëz të sotëm.

Dhe vala e tretë e migracioneve të mëdha shqiptare drejt Anadollit janë dy shekujt e fundit, kur u formuan shtetet e pavarura në Ballkan. Kjo s'do të thotë se s'ka pasur të tilla edhe në shekujt para këtij procesi. Praktikisht në shekullin e XVIII, në fund të tij vlen të përmenden dy lëvizje të mëdha demografike. E para ka të bëjë me qytetin shqiptar të Selanikut. Njoftimi na vjen nga konsulli francez i kohës në këtë qytet, Laskaris, që shkruan se në vitin 1779 në kohën e sulltan Abdylhamitit të I, me mbështetjen e admiralit osman Gazi Hasan Pasha në krye të 30 000 burrave, u dëbuan nga Selaniku brenda 5 ditësh nga guvernatori i qytetit, një pasha mizor e i urryer, më shumë se katërqind mijë shqiptarë, duke përfshirë disa qindra, të cilët bënë pjesë në shpurën e tij...

Në mesin e shekullit XVIII, disa mijëra

shqiptarë punonin atje në hamame, si shitës boze, armëpunues, gurgdhendës apo roje. Disa të tjerë bënë punë sezonale si barinj ose tregtarë bagëtish. Shumë prej zyrtarëve të lartë ishin vetë me origjinë shqiptare e të tjerë. Megjithëkëtë, në shekuj Selaniku s'e humbi kurrë shqiptarësinë e tij. Edhe sot, kur pas 1912-ës ai po bën një shekull duke iu nënshtruar një procesi intensiv dhe të sforcuar të helenizimit nën Greqinë, çdo i katërti banor i tij është shqiptar, pa folur për rrethinat e fshatrat e tij e të Thrakisë Perëndimore. Jo më kot nëpër dasma nga Pogradeci deri në Përmet, në Devoll, në Korçë, Kolonjë, Dangëlli e gjetkë, këngëtarët popullore ja marrin me zë të lartë si sokëllimë malesh, si në ato këngët e lashta majë krahit në Veri të Shqipërisë, që duket sikur del nga fundi i një shpelle, si një ofshamë e stërmadhe: "O Selanik e tatëpjetë / Siç ka qenë do të jetë / Shqipëri me të vërtetë / ..."

Vini re, këngëtarë popullor kërcen nga e kaluara direkt në të ardhmen, duke lënë mënjanë të tanishmen e Selanikut, fati i të cilit dihet.

Dhe vazhdon me nota patetike: "Ç'kërkun greku e bullgari / Kur këtu është shqiptari?!"

Historianët mund ta fshijnë këtë fakt nga shkrimet e tyre, por populli nuk harron asnjëherë, nuk e fshin kurrë nga kujtesa e vet...

Konsulli francez shkruan më tej ndërmjet të tjerash: "Duhet të frikësohemi se ky nacionalitet, i cili është i madh dhe njëkohësisht shumë i varfër, do të shpërdorjë zakonet e tij të mbajtjes së armëve dhe do të bëhet i fuqishëm e i rrezikshëm për këtë Perandori. Të gjithë qytetet e hapura të Rumelisë janë të ekspozuara ndaj shkatërrimeve të tij, që mund ta çojnë atë te portat e Konstandinopojës, nëse ndonjë ambicioz do të dijë si të përfitojë nga numri, kurajoja dhe disiplina e natyrshme e këtij nacionaliteti." Dhe ashtu siç e kishte parashikuar konsulli Laskaris, shumë drejtues shqiptarë u bënë një kërcënim serioz për Perandorinë. Në fillim të shekullit XIX, Mehmet Aliu, një ushtar shqiptar nga Kavalla u bë sundimtar i Egjiptit, themelues i një dinastie mbretërore dhe krijues i një perandorie jetëshkurtër në Afrikë e në tokat arabe. Më pranë atdheut ishte Ali Pasha – Bonaparti mysliman, siç e quante Bajroni – i cili sundoi në gjithë bregdetin perëndimor të Ballkanit nga këshjtjella e tij në Janinë. Ky ishte një pasha shqiptar, i cili po ndërtonte shtetin e tij dhe po ofronte mbrojtje për të krishterët e rajonit. Këtyre ne, duhet t'u shtojmë dhe dy drejtues të tjerë pashalëqesh shqiptarë që konsulli francez nuk i jep, por që ishin edhe ata bashkëkohës me dy të mësipërmit, Bushatllinjët e Shkodrës në Veri dhe Ahmet Kurt Pasha i Beratit, që ishte një pasardhës i denjë i myslimanizuar i princërve Muzakaj. Këto të dhëna për Selanikun i kemi nga profesori amerikan me origjinë hebreje i historisë në Universitetin e Columbias në Njujork, Mark Mazover, në librin e tij "Selaniku, qytet i fantazmave", Tiranë 2011, kur flet për shqiptarët në faqet 148-151.

Është fakt i pamohueshëm historikisht se furia osmane i shtypi kryengritjet e ndryshme të shqiptarëve me zjarr e

me hekur dhe pashallarët osmanë të çdo kohe, të dërguar nga sulltanët, e mbuluan Shqipërinë e tokat shqiptare me lumenj gjaku dhe u bënë në shekuj shkak i lëvizjeve të mëdha e të stërmëdha demografike të shqiptarëve sidomos drejt Stambollit e Anadollit.

**Së dyti**, një lëvizje tjetër e madhe demografike në fund të shekullit XVIII e fillim të shekullit XIX lidhet me emrin e qytetit të Voskopojës, metropol ballkanik e evropian. Me rastin e dy-tre djegieve dhe shkatërrimeve të saj më 1769 e më 1789 e më pas në fillim të shekullit XIX, popullsia e saj në shumicën e saj dërmuese e mbajti frymën drejt qytetit metropol të krejt Perandorisë Osmane. Disa dhjetëra mijëra voskopojarë ja mësyn, u mërguan drejt Stambollit, me të cilin kishin lidhje të shumanshme tregtare, ekonomike, kulturore e deri ato fetare. Askush deri më sot nuk ka folur për këto lëvizje të mëdha njerëzish të këtij qyteti, Voskopojës e të malësisë së saj, krahinës së Oparit drejt Konstandinopojës, përfshi dhe qytetin apo qytezën e Vithkuqit e të tjera, që pati një fat pak a shumë të ngjashëm me të simotrës së saj, të Voskopojës dhe u dogj e u prish edhe ai, afërsisht në të njëjtën kohë.

Vijmë tani, në shekullin XIX. Popullsia që ka pësuar më së tepërmi kanë qenë shqiptarët. Emigrimet e para drejt Turqisë fillojnë nga Përlepi i Maqedonisë. Pastaj vazhdojnë me eksodin nga mbi 600 fshatrat dhe qyteti shqiptar i Nishit të mbi 300 000 banorëve, vazhdojnë me futjen më 1912 nën shtetullën e Serbisë të Kosovës dhe të Greqisë, të Çamërisë e të një pjese të Maqedonisë; vijojnë me ikjet gjatë Luftës së Parë Botërore. Kështu, nuk mund të lëmë pa përmendur emigrimin e qindra, mos themi mijëra Voskopojarëve dhe Oparakëve nga Shqipëria-Voskopoja, kur u dogj në vitin 1916, kishte mbi 500 shtëpi-për në Stamboll. Shumica e banorëve të saj e mbajtën frymën drejt qytetit të madh, me të cilin kishin lidhje të shumta familjare, ekonomike, tregtare, arsimore, kulturore e të tjera prej shekujsh. Ikjet vazhdojnë drejt Turqisë si rezultat i shkatërrimeve të papara se, Shqipëria u bë shesh lufte në Luftën e Parë të Përbotshme e sidomos në fund të saj, kur Jugosllavia e Versajës rikthehet në Kosovë, me Traktatin e Lozanës 1923-24, shkëmbimet e mëdha greko-turke të shqiptarëve, me lëvizjet e kosovarëve më 1938 drejt Turqisë, që u ndërpre në fatmirësisht, deri diku por jo përfundimisht nga Lufta e Dytë Botërore, me ç'vendosjet për arsye politike pas luftës si gjenocidi Çam apo dhe masakrat mbi kosovarët si ajo e Tivarit apo brenda Kosovës e Maqedonisë nga hordhitë serbe e maqedonase; me disa qindra e mijëra të tjerë të emigracionit politik drejt Turqisë, Italisë dhe Evropës Perëndimore, drejt SHBA-së dhe Australisë; me dëbimin e madh në Turqi nga 1954-1960 e më tej, në bazë të Traktatit turko-jugosllav Tito-M. Qypri (ministër i jashtëm i Turqisë) dhe në dekadat vijuese deri në ditët tona një rrjedhje e skajshme pa precedent drejt Stambollit e Anadollit e papërmbytshme e shqiptarëve, pa folur për ikjet në Evropë e Amerikë; pa folur për emigracionin biblik nga Shqipëria pas viteve '90 -të, të shekullit të XX, drejt Evropës e Amerikës. (vijon)

# Një tjetër mrekulli e virgjëreshës Mari, në Belgjike

Në një fshat të vogël, në Sart-Station, në Jalhay, në Belgjike para pak muajsh, në garazhin e shtëpisë së Daniel Lefloch, statuja e virgjëreshës Mari shndrit në drite fosforike sapo hapet garazhi i shtëpisë. Kane qene çifti Daniel e Nadia Lefloch, që para 40 vitesh e kishin blere këtë statujë, në Banneux, në vendin ku është shfaqur Zoja Marie, me 15 gusht 1933. Siç shpjegohen para mediave, statujën e kishin lenë në ruajtje në garazh,

me materiale të tjera të shtëpisë. Por, papritur i zoti shtëpisë sa ka hapur derën e ka habitur drita e shndritshme fosforike. Ai, menjëherë ka njoftuar banoret pranë shtëpisë, pre të pa këtë fenomen. Kjo drite, është një mrekulli e re! Kane njoftuar famullitarin e zonës dhe të gjithë mediat. Ndonëse kane kaluar disa muaj, statuja është kthyer në një kapele vizituesh. Ai vend çdo dite vizitohet nga një numër i madhe njerëzish nga Belgjika e

shtete të tjera. Besimtarët e ndryshëm udhëtojnë me kilometra për tu lutur për të sëmuret e njerëzit me probleme të ndryshme.

Autoritetet e komunës kane marre masa të menjëhershme për ta marre në ruajtje objektin e kësaj shtëpie, si dhe sistemimin e automjeteve. Në të njëjtën kohe restoranti i quajtur "Delices d/Asie", që ndodhet aty pranë, ka afruar ushqim falas në kohe dreke. Sipas buri-

meve të kishës katolike belge së shpejti ekspertet nga Vatikani do të verifikojnë këtë mrekulli të re, të virgjëreshës Mari. Kjo mrekulli e re ka ngjallur interesim të madhe te besimtarët e shumëte, në të cilin nuk mungojte prania edhe të shqiptare që, jetojnë e punojnë në Belgjike.

Përgatiti **Zef Nika**,  
Bruksel, me 25 gusht 2014



**REDAKSIA**  
Kryeredaktor: Lazër Kodra  
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shtyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja